ISSN 1857-6443

Ligjet me shumicë prej dy të tretave konsiderohen të miratuara

Fq.3

ARBEN TARAVARI

Gostivari si rast unik!

Fq.4

Rrëfimi për jetën e terroristit Brenton

Fq.17

www.koha.mk

Koha



KOHA për enigma

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XIII · Numri 3610 · e shtunë-e diel, 16-17 mars 2019 · 1°c | 22°c · 15 DEN

FORUM

Thaçi, sprovë e drejtësisë

Nuk e kam menduar se do të vijë një ditë që të bëhem apologjet i ndonjë politikani. Apologjia e politikanëve sikur nuk kuptohet drejtë nga lexuesit edhe kur ndoshta mund t'i mbrosh me të drejtë. Nuk e di nëse lexuesit pajtohen me këtë. Mbroj parimin se më shumë duhet të merremi me fenomenet se me personat, më shumë me idetë dhe me veprat se me kriterin e simpatisë. Dorën në zemër, këto nuk janë gjëra që mund të ndahen kollaj, sepse, shpesh pas një dukurie qëndron një person dhe anasjelltas, ndaj dhe krijohen simpatitë ose antipatitë. Por, publiku ynë shpesh vuan nga simpati/antipatomanija, dhe shpesh nuk i shikon...

Fq.11

RAJON

Rusët, spiunazh aktiv në Shqipëri

Fq.16

FORUM

57 porosi miqësie për shtetësinë

Fq.10



VENDIMI PËR TË ENJTEN E PËRGJAKSHME NË PARLAMENT

211 VJET BURG PËR "27 PRILLIN"

Procesi gjyqësor filloi në gusht të vitit të kaluar dhe ishte një nga proceset më të mëdha në historinë e re të Maqedonisë së Veriut. Në fillim procesi filloi kundër 33 të akuzuarve, të cilët ishin autorë të sulmit në parlament dhe të sulmeve ndaj deputetëve të pushtetit aktual. Por, pas sjelljes së Ligjit për amnisti, ishin falur 15 persona

Fq.5

Po rrezikohet shëndeti fizik e mendor i fëmijëve

Shkup, 15 mars - Në të kaluarën fëmijët e shfrytëzonin kohën e lirë në ambiente të hapura, me aktivitete fizike e lojëra të ndryshme. Kjo mënyrë e të jetuarit krijonte parakushte për një shëndet stabil, si në pikëpamje fizike ashtu edhe në atë psikike. Kjo ishte edhe arsyeja që fëmijët kishin zhvillim harmonik të trupit, pa deformime dhe çrregullime të tjera anatomike. Por, si është sot gjendja me shëndetin e fëmijëve? Mënyra se si fëmijët sot jetojnë, lë shumë hapësirë për devijime të shumta, në radhë të parë të natyrës fizike. Qëndrimi gjatë kohë para kompjuterit, abstenimi nga aktiviteti fizik, kequshqyerja, ose ushqimi i gabueshëm, kanë bërë që fëmijët sot në të shumtën e rasteve të duken me pamje që nuk korrespondon me moshën e atyre. Zakonisht ata duken të kërrusur, të ngathtë dhe jorrezistues...

Fq.9

ANALIZË

LUFTA E PARË KIBERNETIKE E BOTËS

Kundër Putinit duhet ta marrësh vetë situatën në dorë. Kështu mendoi ndoshta ushtria amerikane kur kreu sulme kibernetike kundër shërbimit sekret rus. Por Putini do të kundërpërgjigjet, është i sigurtë Konstantin Eggert.

Sipas një raportimi të gazetës amerikane "Washington Post", komandoja kibernetike e ushtrisë amerikane e krijuar pak më kohë më parë e bllokoi tërësisht në ditën e zgjedhjeve për kongresin amerikan hyrjen në internet të "Agjencisë për Studimet e Internetit" të Shën Peterburgut, e njohur edhe si "ushtria robotike" e Kremlinit. Kjo solli shqetësim dhe irritim tek funksionarët në Rusi. Sipas të dhënave të gazetës, kjo agjenci fshihet pas ndërhyrjes ruse në zgjedhjet presidenciale në SHBA në vitin 2016 dhe aktiviteteve të tjera në shtetet perëndimore. Me gjasë ajo financohet nga miliarderi Jevgeni Prigoshin, që thuhet se ka lidhje të afërta me Putinin. Ai dyshohet edhe si dora që paguan milicët rusë në Ukrainën Lindore, Siri dhe Afrikë.

Ekspertët e ushtrisë amerikane ia kanë dalë të kapin mailat dhe shkëmbimet e njoftimeve të punonjësve të njësive kibernetike të shërbimit sekret rus. Ushtria amerikane ka lënë lajme, që në sytë e rusëve nuk duhet të lenë asnjë dyshim: ata njihen dhe vëzhgohen.

Putini e ka parë perëndimin deri më tani si të dobët, por më shumë ka pritur një qëndrim defensiv. Gjithmonë ai ia ka dalë të jetë një hap më përpara, qoftë në luftën në Gjeorgji në vitin 2008, në vitin 2014 në Ukrainë, në vitin 2015 në Siri e atë 2016 në SHBA. Nëse raportimi i "Washington Post" është i saktë, Shtëpia e Bardhë nën Donald Trump ka vendosur të ndërrojë kahun e thikës dhe të kryejë kësaj here vetë një sulm. Kjo gjë sigurisht duhet ta ketë bërë Putinin të mendohet. Por mos prisni që ai të dorëzohet me kaq. Atij i vjen rrallë në mendje ideja e tërheqjes taktike, sepse me këtë do të tregonte dobësi. Putin e merr çdo gjë personalisht. Vëmendja, që do të sillte me vete një sulm i tillë nga Uashingtoni do të ishte poshtërim për të.

Megjithatë kjo nuk do të thotë, që ai do të urdhërojë menjëherë trupat e tij kibernetike të kundërsulmojnë. Kreu i Kremlinit preferon një luftë asimetrike. Ai nuk kundërgodet menjëherë dhe asnjëherë me të njëjtat armë. Por megjithëse Donald Trump ia ka zënë vendin Putinit si kampion bote i pakalkulueshmërisë, vetë Putini e sheh veten si mjeshtër të surprizave gjeopolitike.

Një qëllim i Putinit mund të jenë zgjedhjet presidenciale në Ukrainë më 31 mars. Në vendin e aneksuar apo pushtuar pjesërisht nga Rusia, është edhe më e lehtë se në SHBA të shkaktosh kaos. Po ashtu aftësitë e Ukrainës për sigurinë në rrjet janë shumë më pak të zhvilluara se ato të Rusisë. Mund të priten lajme provokuese të rreme që kanë si objekt sektorin bankar apo qendrat e furnizimit.

Qëllim tjetër: Zgjedhjet e ardhshme europiane në maj. Edhe nëse partitë euroskeptike populiste do të bien pak në elektorat, Putin do të vazhdojë t'i mbështesë ato, po ashtu si edhe parti të majta besnike. Objektivi i tij: Një Parlament Europian që ndihmon në thellimin e hendeqeve brenda BE.

E të mos harrojmë Britaninë e Madhe: Në axhendën e Putinit me siguri mund të jetë edhe mbështetja e partisë laburiste të Jeremy Corbyn. Qëndrimet kritike të Corbyn kundrejt NATO-s apo gatishmëria për të dëgjuar argumentat e Moskës e bën atë një pasues të dëshiruar pas Theresa Mayt, pavarësisht si shkojnë punët me Brexit. Putin mund edhe të testojë rezistencën e infrastrukturës së NATO-s në kahun lindor të saj në vendet balltike. Kushedi se për çfarë arsye, Moska beson, se aty është pika e dobët e NATO-s. Aty Putini e ka më të lehtë të tregojë muskujt.

Qëllimi final do të jetë vetë SHBA. Kongresi me shumë gjasa do të vendosë për sanksione të reja kundër Rusisë. Në listë mund të jenë dy masa që duhet ta prekin Vladimir Putinin drejtpërdrejt. Fillimisht kongresi dëshiron që të gjitha ministritë e SHBA të bëjnë publike informacionet që kanë mbi shëndetin e Putinit. Përveç kësaj, kongresi pritet të kërkojë një hetim për vrasjen e kritikut të Kremlinit, Boris Nemcov nën drejtimin e SHBA. Nemcov u vra në shkurt 2015 shumë pranë Kremlinit. Autorët e dyshuar janë kapur dhe dënuar. Por se kush qëndron pas vrasjes dhe kush e dha porosinë për të mbetet e paqartë. Policia e kontrolluar nga Kremlini dhe drejtësia i kanë penguar hetimet deri më tani. Shanset që këtë ta zbulojë FBI-ja dhe CIA janë të vogla. Por thjesht përmendja e vrasjes gati barazohet me fajësimin e Putinit- Në të dyja rastet, Putini nuk ka rrugë tjetër, veçse të reagojë.

Një objektiv tjetër mund të jenë edhe zgjedhjet paraprake presidenciale në SHBA. Pritet që Rusia të ndërhyjë edhe në këto zgjedhje paraprake vitin e ardhshëm. Lufta e parë kibernetike e botës sapo ka filluar. *(DW)*



GAZETARËT INJORANTË NGATËRROJNË SKENDERBEUN

"Sipas gazetarëve injorantë të portalit "Opinion", në armën e atentatorit të masakrës ishte i shkruar dhe emri i Skënderbeut, dhe shpjegimi që jepnin këta analfabetë gazetarë ishte se atentatori kishte shkruar në armë emrat e gjithë atyre që luftuan muslimanët! A pika që nuk ju bie!
Scanderborg është një qytet në Danimarkë! Emri i këtij qyteti qe shkruar në armë!", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtarja nga tirana, Arlinda Guma.



SHTETI I KOSOVËS DUHET TA MBROJË SLLOBODAN PETROVIQIN

"Kërcënimet e shtetit serb dhe presidentit të tij Aleksandar Vučić kundër sigurisë dhe jetës së politikanit dhe ish-zv. kryeministrit të Kosovës Slobodan Petrović duhet të merren seriozisht nga shteti i Kosovës.
Kosova duhet të angazhojë krejt agjensitë dhe organet e sigurisë për të mbrojtur jetën e Petrovićit të rrezikuar nga i pari i Serbisë dhe shteti serb.
Duhet të bisedohet edhe me partnerët ndërkombëtarë që të ndihmojnë në pengimin e ekzekutimit të planit për likuidimin e Slobodan Petrovićit.
Serbia duhet të paralajmërohet që çdo akt cenues kundër shtetasve në territorin e një shteti tjetër është i ndaluar dhe i dënueshëm me ligjet ndërkombëtare", ka shkruar një status në Facebook, ish pjesëtari i Batalionit 'Atlantiku', Uk Lushi.



NUK DUHET T'I LËMË PRINDËRIT TANË TË VETMUAR

"E përgëzoj ligjëruesin e sotëm në xhaminë tek Veterniku, për temën që e kishte zgjedhë dhe për shtjellimin e saj në mënyrë shembullore. Boshti i temës ishte, me sa kuptova, respekti e detyrat tona ndaj prindërve dhe dashuria jonë për atdheun.
Në ligjëratën e tij ai ishte mjaftë konciz, i logjikshëm, jo i stërgjatur dhe foli me fakte.
Ai tha se histeria psikologjike e përhapur gjithandej se në Kosovë nuk ka përspektivë, nuk ka të ardhme e nuk ka punë, është e dënueshme në Islam, logjikisht e papranueshme e kombtarisht e dëmshme.
Kjo vetëdije është e rrezikshme për të gjithë ne, rrjedhimisht për Kosovën!
Në Kosovë, tha hoxha, ka të ardhme, ka perspektivë dhe mund të bëhet punë. Mjafton ta duam atdheun, ta respektojmë e ta ruajmë.
Është detyrë jona t'i përkushtohemi deri në frymën e fundit atdheut, e jo të ikim nga aty e ta lëmë pa njerëz, pa rini e pa kuadro që i duhen.
Ikja nga atdheu, sipas Islamit, lejohet vetëm në raste tejet specifike. Jo kështu siç po bënë rinia jonë. Ne po biejmë në kurthën e kësaj gjendje psikologjike që duhet tejkaluar patjetër. Kjo logjikë e patolerueshme i shkon për shtati armiqve tanë. Gjithashtu, ne nuk duhet t'i lëmë prindërit tanë të vetmuar. Po ua vrasim shpirtin atyee me ikjen nga ata e nga vendi. Ne duhet tu rrimë pranë, të kujdesemi për ta, siç duhet t'i rrimë afër atdheut tonë, shtoi në fjalën e tij hoxha në xhaminë tek Veterniku.
Hoxhë i nderuar, nuk të njoh cili je, ama, Allahu të shpërbleftë për ligjëratën e sotme në këtë ditë xhumaje...!", ka shkruar në profilin e tij në facebook, teologu Mustafa Bajrami.

MEDIACitate

Schmidt për Shqipërinë: Edhe qeveria mban përgjegjësi

Ndërsa qeveria gjermane kritikon qartë opozitën e Shqipërisë për bojkotin e parlamentit, raportuesi për Shqipërinë në Komisionin e Jashtëm, Christian Schmidt mendon se edhe qeveria ka përgjegjësi për krizën.
Ndërsa qeveria gjermane kritikon qartë opozitën e Shqipërisë për bojkotin e parlamentit, raportuesi për Shqipërinë në Komisionin e Jashtëm Christian Schmidt mendon se edhe qeveria ka përgjegjësi për krizën.
Raportuesi i Shqipërisë në Komisionin e Jashtem, Christian Schmidt, mendon se edhe qeveria mban përgjegjësi për situatën aktuale në Shqipëri: "Kjo nuk është normale. Parlamenti jeton nga debati. I takon qeverisë që të garantojë bashkëpunimin parlamentar", tha ish-ministri gjerman për DW. Schmidt është që nga fillimi i vitit raportues për Shqipërinë në Komisionin e Jashtëm në Bundestag, njëri nga komisionet që vendos për çeljen e negociatave në BE.
Schmidt tha për DW se së shpejti planifikon të shkojë vetë në Shqipëri për t'u informuar vetë për gjendjen.
"Veçanërisht dua të shoh se sa përfshihet opozita në procedurat parlamentare", theksoi ai
Vendimi i Gjermanisë për çeljen e negociatave do të varet nga progres-raporti i Komisionit të Bashkimit Evropian që do të publikohet më datën 29 maj. Por për të dhënë miratimin përfundimtar në Këshillin e BE-së, më 19 qershor, Gjermanisë do t'i duhet që të marrë aprovimin e Bundestagut.
Në një takim me deputetë nga komisioni i Bundestagut për Çështje të Bashkimit Evropian, ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj kërkoi mbështetjen e deputetëve gjermanë për negociatat. "Vendimi pozitiv i Këshillit në qershor do t'i japë një hov të ri jo vetëm proceseve të reformave brenda vendit, por do të shërbejë më së miri për të krijuar një sinergji të re bashkëpunimi mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe do të forcojë stabilitetin dhe sigurinë në rajonin tonë", tha kreu i diplomacisë shqiptare, sipas një deklarate për shtyp të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
Ndryshe nga kolegu i tij kristiansocial, Florian Hahn, i cili në një intervistë të mëparshme për DW nuk e hodhi poshtë idenë e ndryshimit të kufirit mes Kosovës dhe Serbisë, ish-ministri agrar i Gjermanisë, Christian Schmidt, tha për DW se ai nuk e favorizon kurrsesi këtë opsion: "Në të gjithë Ballkanin nuk gjen një territor të pastër etnikisht, prandaj nuk e kuptoj këtë idenë e shkëmbimit të territoreve mbi baza etnike," – tha Schmidt për DW. Ai shtoi se kjo nuk është një çështje që u përket vetëm dy vendeve, por se duhen pyetur edhe fqinjët.
Schmidt paralajmëroi gjithashtu edhe në drejtim të Shqipërisë që të mos e ngatërronte më keq diskutimin duke përdorur retorika dhe simbolika që favorizojnë një vizion shqiptaro-madh. "Nga kjo duhet hequr dorë. Kush hyn në BE, duhet të tregohet i kujdesshëm me këmbime territoresh," tha Schmidt për DW.

(Lajmi.net, 15 mars)

XHAFERI PËR LIGJET QË I KTHEU IVANOVI

LIGJET ME SHUMICË PREJ DY TË TRETAVE KONSIDEROHEN TË MIRATUARA

Deri tani nga Ivanovi janë kthyer gjithsej 15 ligje, prej të cilave tre-katër janë me shumicë prej dy të tretave nga fusha e drejtësisë dhe të drejtave, që nuk do t'i nënshtrohen përsëritjes së procedurës

Koha — Zejnulla VESELI

Shkup, 15 mars -Ligjet që nuk morën nënshkrim prej presidentit Gjorge Ivanov, ndërsa u miratuan me shumicë prej dy të tretave - do të konsiderohen të miratuara, ndërsa ligjet tjera do të kthehen në procedurë parlamentare, deklaroi kryetari i Parlamentit të Maqedonisë të Veriut, Talat Xhaferi.

"Obligim i Parlamentit është t'i miratojë ligjet dhe obligimi im është në kohën e duhur, më saktë menjëherë pas miratimit, t'i nënshkruajë letrat e dërguara dhe pjesën e dekretit ku është paraparë nënshkrimi im. Për ligjet që nuk miratohen me shumicë prej dy të tretave presidenti i shtetit është i obliguar në afat prej shtatë ditëve të përgjigjet nëse do t'i nënshkruajë ose jo. Për ligjet që janë miratuar me shumicë prej dy të tretave presidenti, sipas Kushtetutës, është i obliguar menjëherë t'i nënshkruajë dekretet. Edhe në rastin e parë edhe në të dytin presidenti ka refuzuar ta bëjë këtë, i ka kthyer ligjet me sqarim se ai është thirrur ta mbrojë Kushtetutën. Në këtë situatë ligjet që janë miratuar me shumicë prej dy të tretave nuk mundet sërish të kthehen në procedurë parlamentare dhe konsiderohen të miratuara. Ligjet tjera, sipas Rregullores, jam i obliguar në afat prej 30 ditëve nga dita e miratimit të ligjeve t'i kthej në procedurë të serishme parlamentare, gjegjësisht t'i vendosi në seancë, dhe gjithsesi ky afat nga ana ime do të respektohet", tha Xhaferi.

Ai sqaroi se nuk ka asnjë pengesë Parlamenti të mund të punojë në kohë të fushatës parazgjedhore, por kjo situatë thotë, nuk kërkon me çdo çmim Kuvendi të punojë sepse afati është të vendoset në seancë, ndërsa vendosja mund të zgjas për shkak debatit të mundur, dhe për këtë nuk mund të parashikohet se nëse vendosen në seancë, ligjet menjëherë të miratohen me shumicën e nevojshme. Sa u përket implikimeve të mundshme në lidhje me vendimet e Këshillit të BE-së, Xhaferi vlerëson se nuk mund të ketë pasoja dhe nuk duhet të ketë, sepse Parlamenti, thotë, në mënyrë përkatëse i ka miratuar zgjidhjet ligjore në afatin e paraparë që u parashikua në kontekst të BE-së. Por edhe ato, shtoi, janë të vetëdijshëm se Kuvendi edhe në situatën e përsëritur do t'i miratojë ligjet dhe nuk do të pres të miratohen, sepse pas shumë ligjeve qëndrojnë të gjitha partitë politike të përfaqësuara në parlament, do të thotë unanimisht dhe për me shumicë prej dy të tretave me pjesëmarrjes e opozitës.

Deri tani nga Ivanovi janë kthyer gjithsej 15 ligje, prej të cilave tre-katër janë me shumicë prej dy të tretave nga fusha e drejtësisë dhe të drejtave, që nuk do t'i nënshtrohen përsëritjes së procedurës.

Deklarata e Mickovskit, reagon edhe ambasada gjermane

Shkup, 15 mars - Krahasimi i procedurave të shërbimeve të drejtësisë të Maqedonisë së Veriut me proceset e Nirnbergut është jopërkatës, konsideron Ambasada e RF të Gjermanisë në Shkup. Në reagimin e saj me shkrim në deklaratën e liderit të VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickoski, ku gjykimi për rastin "27 prill" e ka krahasuar me proceset e Nirnbergut, Ambasada Gjermane thekson se "me këtë minimizohen veprat e kriminelëve nazistë". Edhe ambasada e SHBA-së në Maqedoninë e Veriut dje reagoi në "siç vlerësoi" deklaratat nxitëse të liderëve partiakë që shkaktojnë frikë dhe ndarje, veçanërisht kur në mënyrë jo korrekte për qëllime politike përdoren ngjarje historike siç janë Proceset e Nirnbergut. "Gjuha e tillë është e rrezikshme dhe nuk kontribuon për dialog produktiv lidhur me progresin e vendit. Është kyçe që liderët këtu të angazhohen në dialog më të civilizuar që do të kontribuojë për stabilitetin dhe prosperitetin e Maqedonisë së Veriut", publikoi Ambasada e SHBA-së në profilin e saj në Fejsbuk.

Publicitet

Kreu i Gostivarit, Arben Taravari, në një prononcim për gazetën KOHA thotë se është në pritje të një takim të paralajmëruar nga vet kryeministri me qëllim që të ballafaqohen argumentet dhe, siç shprehet ai, të sqarohet se kush në fakt e ka gabim. Nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut thonë se në agjendën e kryeministrit nuk ka të paraparë ndonjë takim me kreun e Gostivarit

Ç'PUSHTETIZIMI I ARBEN TARAVARIT

GOSTIVARI SI RAST UNIK!

Koha Destan JONUZI

Shkup, 15 mars - Ministria e Arsimit më 18 shkurt ia ka marrë për herë të dytë kompetencat Komunës së Gostivarit, me arsyetimin se janë konstatuar parregullsi gjatë procedurës së shkarkimit dhe emërimit të drejtorëve. "Jemi të zhgënjyer nga veprimi antiligjor i kryetarit të Gostivarit, i cili për fat të keq dështoi në kryerjen e obligimeve", kumtoi Ministria e Arsimit, në arsyetimin e saj. Ishte pikërisht kjo arsyeja, që më 20 shkurt, kreu i Aleancës për Shqiptarët (ASH), Ziadin Sela, anuloi takimin me kryeministrin Zoran Zaev, në të cilin do të diskutohej për kandidatin konsensual për president. Ndërkohë që kryeministri Zaev deklaroi se si një ish kryetar komune (Strumicës), është i vetëdijshëm se çka nënkupton marrja e kompetencave për cilëndo komunë pa marrë parasysh a është ajo Struga, Kumanova, Gostivari..., dhe paralajmëroi se do të kërkohet zgjidhje në takimin e përbashkët me kryetarin e Gostivarit dhe ministrin e Arsimit. "Gostivari është një nga qytetet më të mëdha në shtet dhe se nuk do të lejojë dallimet politike të jenë pengesë për zhvillim në cilindo mjedis", deklaroi Zaev, pas dështimit të takimit me Selën.

Edhe përkundër kësaj deklarate nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut thonë se në agjendën e kryeministrit nuk ka të paraparë ndonjë takim me kreun e Gostivarit Arben Taravari dhe Ministrinë e Arsimit, Arbër Ademi. Ndërkaq, nga ana tjetër kreu i Gostivarit, Arben Taravari në një prononcim për gazetën KOHA thotë se është në pritje të një takim të paralajmëruar nga vet kryeministri me qëllim që të ballafaqohen argumentet dhe, siç shprehet ai, të sqarohet se kush në fakt e ka gabim

"Nuk ka pasur një takim të tillë. Përpos asaj që tash është hera e dytë që na merren kompetencat. Ne kemi vepruar në bazë të ligjit dhe rregullave që vlejnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kemi qenë shumë të vëmendshëm këtu duke angazhuar jurist me përvojë, njerëz të cilët kanë punuar në arsim vite me radhë dhe përpos asaj që kryeministrit i dërguam të gjitha materialet në lidhje me ndryshimet e drejtorëve në Gostivar, jo vetëm kryeministrit por edhe 7 ambasadave kryesore në Republikën e Maqedonisë së Veriut me të gjitha dokumentet, por përsëri nuk kemi pasur me kryeministrin asnjë lloj bisede lidhur me këtë, përveç asaj që tha përmes mediave se duhet të respektohen ligjet", deklaroi Taravari për gazetën KOHA. Ai thotë se është që të respektohet ligji, por se i njëjti të vlejë njësojë si në Gostivar, ashtu edhe në Tetovë, Strugë, Kavadar, Strumicë etj

"Unë e pres atë takim bashkë me ekipin tim me të cilët kemi vepruar në anulimin e konkurseve njësojë si kur se ka anuluar vet ministri i arsimit, duke i bërë konkurset ata kanë gabuar në emri të drejtorëve kur i kishin kompetencat edhe në radhë të parë kur i morën, i kanë shpallur vetëm në dy gazeta, ndërsa duhet të shpallen në tre gazeta, pas asaj vetë ministri arsimit ka anuluar një konkurs, dhe në bazë të asaj si ka anuluar ai ashtu i kam anuluar edhe unë dhe pres që kryeministri të thërret në atë takim dhe ti nxjerrim argumentet dhe faktet dhe të shihet se kush ka vepruar ashtu si duhet dhe kush ka gabuar. Marrja e kompetencave për së dyti herë është vetëm se vendim politik i ministrit i cili e dinë se ka gabuar por ka pasur presion prej strukturave partiake të BDI-së, pasi që e humbi Gostivarin", thekson Taravari. Duke u thirrur në "revanshizmin" politik, Taravari thotë se kompetencat i janë marrë edhe për arsye se partia të cilës i takon ai është në epërsi 3 me 1 ndaj BDI-së në qytetin e Gostivarit.

"Nuk ka pas punë që pushteti qendror nuk e ka penguar Gostivarin, aty ku kanë mundur të pengojnë nuk kanë lënë pa penguar, kompetencat e Kulturës nuk i kthehen Gostivarit, kompetencat në arsim i merren dy herë, kjo nuk ka ndodhë në historinë e Maqedonisë së Veriut, që kompetencat të merren për së dyti herë. Vazhdimisht ka tendenca për ti marrë kompetencat edhe të urbanizimit, por atje nuk mund të gjejnë asnjë lëshim, kemi tentuar dhe kemi luftuar me mafinë urbane që të mbajmë balancë mos ndodhe asgjë e pa ligjshme", shprehet Taravari. Investimet e Qeverisë, shton më tej ai, për Komunën e Gostivarit vitin e kaluar kanë qenë 35 mijë euro, ndërsa investimet kryesisht janë bërë me para vetanake të komunës dhe me ndihmën e faktorit ndërkombëtar, respektivisht ambasadave.

"Ndihmën e çdo kujt e kemi pas përveç ndihmës së shtetit. Mos harrojmë se buxheti i shtetit mbushet edhe paraqet e qytetarëve, pa marrë parasysh se kush e udhëheq komunën e Gostivarit, Qeveria duhet të sillet njësojë me të gjithë kryetarët e komunave pa marrë parasysh se a janë ato të pozitës apo opozitës. Ato i marrin parat e qytetarëve dhe duhet të shpërndahen në mënyrë proporcionale në të gjitha qytetet. Por, kemi qenë absolutisht të diskriminuar", nënvizoi Taravari. Komuna e Gostivarit është rast unik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku brenda një viti i merren dy herë kompetencat në arsim. Deri më tani nuk ka ndodhur që një komune ti merren dy herë kompetencat në arsim apo ndonjë sektor tjetër.

ZAEVI PËR MOSDEKRETIMIN E 11 LIGJEVE

Presidenti nuk e respekton Kushtetutën

Shkup, 15 mars - Mosrespektim i Kushtetutës është edhe nëse nuk përdoret emri i ri kushtetues i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka deklaruar kryeministri Zoran Zaev, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve për procedurat e mëtejme me ligjet të cilat nuk u nënshkruan nga presidenti Gjorge Ivanov. Zaev ka shprehur besimin se shërbimet do të gjejnë zgjidhje të përbashkët me qëllim të mundësohet përdorimi i ligjeve të miratuara, të cilët nuk morën nënshkrimin nga shefi i shtetit. Parlamenti të hënën ka bërë të ditur se Ivanovi nuk i ka nënshkruar dekretet për shpalljen e 11 ligjeve. Ligjet të cilët presidenti ka refuzuar të nënshkruajë do të duhet përsëri të gjenden në procedurë parlamentare dhe do të duhet të miratohen me 61 deputetë me çka ai do të ketë për detyrë të nënshkruajë dekretin për hyrjen në fuqi të tyre.

Nga 1 prilli, Parlamenti nuk do të mblidhet për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale, por për procedurat e mëtejme lidhur me këtë do të pritet mendimi i kryeparlamentarit Talat Xhaferi, i cili është jashtë shtetit për shkak të nënshkrimit të Protokollit për anëtarësim në NATO. Nuk përjashtohet mundësia Parlamenti të punojë edhe gjatë zgjedhjeve presidenciale që të miratohen ligjet reformuese, që nga vendi i kërkon BE-ja. "Vendit tonë nuk i nevojiten bllokada nga arsye subjektive ose tjera të cilat mund të ekzistojnë për këto çështje. Besoj se do të gjenden zgjidhje", ka thënë kryeministri.

Ai pret që nga 1 prilli Parlamenti të punojë, siç tha, "në përbërje të plotë". Lidhur me atë se kur pret të mbahet dueli televiziv me liderin opozitar të VMRO-DPMNE-së Hristijan Mickoski, Zaev ka thënë se do të ndodhë kur të jetë gati mediumi, ndërsa si mundësi ka përmendur televizionin Kanal 5. "Unë jam i gatshëm, jam këtu, përveç më 19 mars kur udhëtoj për Bruksel për shkak të prezantimit të sukseseve të vendit para Këshillit për stabilizim dhe asociim, por ajo është vetëm një dite. Çfarëdo dite tjetër jam këtu dhe besoj se në kënaqësi të qytetarëve do të ketë duel siç duhet të ketë", ka thënë Zaev.

Antikorrupsioni do të verifikojë pasurinë e Gjorge Ivanovit

Shkup, 15 mars - Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit publikoi se do të kryejë verifikimin e pasurisë të presidentit Gjorge Ivanov. Siç deklaroi dje në seancën e pestë kryetarja e KSHPK-së, Biljana Ivanovska, Komisioni i Antikorrupsionit verifikimin do ta kryejë sipas zërave të dëgjuar, në pajtim me nenin 92 dhe 85. Ivanovit mandati i skadon më 12 maj të këtij vitit, ndërsa verifikimi i gjendjes së pasurisë është me qëllim që të shihet se cili është ndryshimi i gjendjes së pasurisë së presidentit në të dy mandatet e tij. Javën e kaluar KSHPK-ja publikoi se lëndë për procedurë e Komisionit të Antikorrupsionit do të jenë edhe avancimet dhe emërimet parazgjedhore në Armatë, ku siç citojnë, Ivanovi i ka nënshkruar në periudhë zgjedhore.

Sela: Ti je në burg sepse unë jam gjallë

Shkup, 15 mars - Në një ndejë me Fetain, më pati thënë: "Nuk shqetësohem shumë për dënimin sa shqetësohem për faktin që po më fusin në një thes me kriminelët...". Miku im, krimi yt i vetëm është se fëmijët e mi akoma kanë mundësinë të thërrasin babanë e tyre dhe unë t'ju përgjigjem. Kështu e nis reagimin e tij në Facebook, lideri i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, pas dënimit me 7 vite burg të Feta Alimit, policit që i shpëtoi jetën Selës natën e përgjakshme të 27 prillit në Parlament.

" Në një ndejë me Fetain, më pati thënë: 'Nuk shqetësohem shumë për dënimin sa shqetësohem për faktin që po më fusin në një thes me kriminelët...'. Miku im, krimi yt i vetëm është se fëmijët e mi akoma kanë mundësinë të thërrasin babanë e tyre dhe unë t'ju përgjigjem. Ti bëre 'mëkatin' e ruajtjes së jetës. Ti je në burg sepse unë jam gjallë, prandaj ti s'ka se si të jesh si ata që më deshën të vdekur. Si ata që sot janë të lirë, por me duar e me këmbë të zhytur në krim. Po po janë të lirë, biles edhe me pozicione qeveritare. Nëse dikush nëpërmjet dënimit tënd do të tregoj simbolikën se regjimi i kaluar kishte dy komponentë edhe maqedon edhe shqiptar, ti nuk je kjo simbolikë. Ti je simbolika e shqiptarit të zakonshëm që e do jetën, që e do lirinë. Ti je simbolika e shqiptarit që i montohen akoma procese politike. Je simbolika e gjyqësisë së politizuar dhe me dy standarde. Simbolika e regjimit të kaluar s'mund të jetë Fetai, por është Aliu me Nikollën. Ti dhe dënimi yt sot po që jeni simbolika e regjimit të tanishëm të Aliut dhe Zoranit", shkruan Sela. "E rëndë sot dita Feta! Më mirë kurrë mos i kisha hapur sytë në mbrëmjen e 27 prillit sesa të jetoj këtë turp. Po, ti je fajtor. Ke fajin që unë sot ndihem me fajin e pafuqisë për të të ndihmuar. Ke fajin që jam gjallë", përfundon reagimin Ziadin Sela.

VENDIMI PËR TË ENJTEN E PËRGJAKSHME NË PARLAMENT

211 VJET BURG PËR "27 PRILLIN"

Procesi gjyqësor filloi në gusht të vitit të kaluar dhe ishte një nga proceset më të mëdha në historinë e re të Maqedonisë së Veriut. Në fillim procesi filloi kundër 33 të akuzuarve, të cilët ishin autorë të sulmit në parlament dhe të sulmeve ndaj deputetëve të pushtetit aktual. Por, pas sjelljes së Ligjit për amnisti, ishin falur 15 persona

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 15 mars - Me gjithsej 211 vite burg janë dënuar 17 të akuzuarit që kishin mbetur nga 33 më parë për dhunën në Parlament më 27 prill të vitit 2017, të njohur në opinion si "27 prilli". Rastin e udhëhoqi gjykatësja Dobrilla Kacarska, ndërsa përfaqësuese e akuzës ishte prokurorja Vilma Ruskovska. Gjykatësja Kacarska tha se 17 të akuzuar ngarkohen nga neni 313 i Kodit Penal, ndërsa janë dyshuar për "rrezikim terrorist të rendit kushtetues", duke rrezikuar kështu jetën e deputetëve dhe duke shkaktuar frikë dhe pasiguri tek qytetarët e Maqedonisë së Veriut.

Me këtë rast, Mitko Çavkov, ish-drejtori i Byrosë për Siguri Publike, u dënua me 18 vjet burg, Dushko Lazarov me 15 vite, Goran Gjoshevski-Levi 15, Mitko Peshov 15, Oliver Popovski 13, Munir Pepiq 15, Abdulfeta Alimi 7, Oliver Radullov 10, Jane Çento 15, Igor Jug 12, Aleksandar Vasilevski-Ninxha 8, Nikolla Mitrevski-Kolo 15, Mlladen Dodevski 12, Gorançe Angelovski 12, Vllatko Trajkovski 15 dhe Uillijam Mihajlovski 14. Igor Durlovski ndërkohë është liruar nga aktakuza, pasi siç tha gjykatësja Kacarska, Prokuroria nuk arriti të dëshmojë aktakuzën kundër Durlovskit.

Pas shqiptimit të dënimeve, prokurorja propozoi vazhdim të masës paraburgim për të dënuarit Mitko Çavkov, Jane Çento, Igor Jug, Mlladen Dodevski dhe Vllatko Trajkovski, sepse sipas saj, ekziston rrezik nga arratisja. Për të tjerët, të dënuar gjithashtu me burg, është kërkuar përcaktim i masës së arrestit deri në hyrjen në fuqi të aktvendimit. Procesi gjyqësor filloi në gusht të vitit të kaluar dhe ishte një nga proceset më të mëdha në historinë e re të Maqedonisë së Veriut. Në fillim procesi filloi kundër 33 të akuzuarve, të cilët ishin autorë të sulmit në parlament dhe të sulmeve ndaj deputetëve të pushtetit aktual. Por, pas sjelljes së Ligjit për amnisti, ishin falur 15 persona.

Ndryshe, të akuzuarve për dhunën e përgjakshme në Parlament, Prokuroria Publike ua shtoi edhe pesë organizatorë të tjerë të ngjarjeve më 27 prill: Nikolla Gruevskin, Trajko Veljanoskin, Mile Janakieskin, Spiro Ristovskin dhe Nikolla Boshkovskin, të cilët akuzohen për veprën penale "rrezikim terrorist të rendit kushtetues dhe të sigurisë".

Në ndërkohë, reagimi i parë kundër dënimit të policit Abdylfeta Alimi ka ardhur nga Aleanca për Shqiptarët. "Edhe pse në një vend demokratik nuk komentohen vendime e gjykatës dhe aktgjykimet, megjithatë Maqedonia e Veriut është shumë larg demokracisë dhe drejtësisë. Shqiptimi i dënimit me 7 vite heqje lirie për Abdylfeta Alimin që tani njihet si njeriu i vetëm që shpëtoi jetën e Liderit të ASH, Ziadin Sela natën e 27 Prillit, për ne si ASH paraqet tendencë për të amortizuar dënimet tjera të grupit të organizuar paraprakisht duke projektuar dhe realizuar goditjen mbi Kuvendin mbi deputet dhe mbi të gjitha likuidimin fizik të Ziadin Selës. Është e palogjikshme dhe pa kuptimtë që Feta Alimi të ngarkohet me lëndën terrorizëm, dhe i njëjti të nivelizohet me e grupin që dhunuan Kuvendin dhe deputet e Kuvendit të RMV. Feta Alimi në këtë proces gjyqësor po trajtohet si viktimë me të cilët po mundohet të rruhet 'balanci' etnik ndaj të dënuarve tjerë të cilët opinioni tani më njeh si urdhërues dhe ekzekutues të ngjarjeve të 27 Prillit", thuhet në reagimin e ASH-së. Feta Alimi, vazhdon më tej reagimi, sot duhej të shpërblehej nga shteti që arriti të shpëtojë një jetë njeriu, edhe atë një deputet dhe lider të popullit siç është Ziadin Sela duke vënë në rrezik dhe sakrifikuar jetën e tij, për ta shpëtuar atë, dhe jo të dënohet me 7 vite burg dhe të nivelizohet me ata që i pamë nëpër ekranet televizive se si po goditnin me mjete të forta mbi deputetë dhe natën e trishtë të 27 Prillit.

Mitko Çavkov u dënua me 18 vjet burg. Çavkov, i cili në seancën gjyqësore u soll nga burgu hetues i Shutkës, sipas gjykatëses Kacarska, nuk e ka ndaluar dhunën e huliganëve, duke mos i dhënë urdhër policisë që të parandalojnë hyrjen në Parlament. Ai, sipas vendimit përfundimtar, madje nuk i është përgjigjur ish-ministrit Agim Nuhiu.

Igor Durlovski ndërkohë është liruar nga aktakuza, pasi siç tha gjykatësja Kacarska, Prokuroria nuk arriti të dëshmojë aktakuzën kundër Durlovskit. Ndryshe, tenori Durllovski ishte i vetmi nga organizatorët e protestave "Për Maqedoni të përbashkët", që nuk kërkoi amnisti nga Gjykata.

ALIMI: NUK DO TË JETOJË 200 VJET

Ish-sigurimi i Parlamentit, Abdulfetah Alimi, duke e komentuar propozim e Prokurorisë për shqiptimin e masës së "paraburgimit", tha se nuk i bie ndërmend të arratiset. "Ju premtoj se në asnjë çast nuk më kujtohet që të arratisem. Nëse ishte ashtu, atëherë nuk do të vija nga Zvicra dhe të paraqitem në polici vet. Dëshiroj të më kuptoni me seriozitetin më të lartë, pasi që këtë deklaratë e jap para gjithë opinionit. Unë nuk do të jetoj 200 vite. Ju lutem deri në vërtetimin e Gjykatës së Apelit, të mbrohem në liri", tha Alimi. Alimi u dënua me 7 vite burg, pasi siç tha gjykatësja Kacarska, nuk i ka penguar huliganët që u futën në Parlament, ndërsa i ka dhënë çelësat kolegut të tij. Megjithatë, tha Kacarska, gjykata e merr parasysh veprimit e tij që e shpëtoi nga vdekja deputetin Ziadin Sela. Për familijarët e Alimit, ky dënim ishte një shok i vërtet. Mes lotësh ata u shprehën se gjatë procesit gjyqësor aspak nuk është vërtetuar akuza që ishte ngarkuar Fetah Alimit.

KRONIKË

Konfiskohet armatim në fshatin Çajle

Pjesëtarët e policisë nga Sektori për punë të brendshme Tetovë, Zyra e jashtme për punë kriminalistike në Gostivar, në bashkëveprim me stacionin policor Çegran, të enjten nga ora 6 e 45 minuta kanë kryer bastisje në shtëpinë dhe hapësirat ndihmëse të 42 vjeçarit R.M nga fshati Çajle e Gostivarit. Gjatë bastisjes së realizuar me urdhër të gjykatësit, është gjetur pistoletë "Gllok" e kalibrit 9 milimetër, të cilin e ka poseduar me leje, pushkë për gjuajtje karabin "Hajnel" e kalibrit 30 milimetër, me leje në emër të një personi tjetër dhe gjithsej 136 plumba të kalibrit të ndryshëm. Menjëherë më pas, në oborrin e shtëpisë tek fqinji i tij janë gjetur 2 pistoleta "CZ" të kalibrit 6.35 milimetër, një revolver "Smith " i kalibrit 45 milimetër, një thikë me pesë plumba dhe një bateri llambë me karikues, të cilat një person i panjohur i ka hedhur nga nënkulmi i shtëpisë së personit R.M, derisa ai ka qenë i arrestuar nga ana e pjesëtarëve të policisë. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Arrestohet një person në Pallaticë

Të enjten e rreth orës 14 e 50 minuta, me urdhër të gjykatësit është arrestuar 48 vjeçari B.R nga fshati Pallaticë i Tetovës, i dënuar me dy vite burg për shkak se ka kryer vepër penale "Përpunim ilegal, mbajtje dhe tregti me armë, ose materie shpërthyese". Pas arrestimit, B.R. është dorëzuar në burgun e Tetovës për vuajtjen e dënimit.

Një vozitës aksidenton dy të rinj

Tek rrethrrotullimi në mes të Bulevardit "Vidoje Smilevski-Bato" dhe rrugës "Vëllezrit Milladinovi" në Tetovë, të enjten rreth orës 16 e 40 minuta, vetura e tipit"Golf"me targa të panjohura të cilën e ka drejtuar person i panjohur, ka aksidentuar dy këmbësorë nga Tetova, 21 vjeçarin E.R. dhe 19 vjeçarin E.R, dhe menjëherë ka lëshuar vendin e ngjarjes. Këmbësorët e aksidentuar, me anë të një veture tjetër janë dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, ku janë mbajtur për mjekim të mëtutjeshëm. Janë kryer hetimet dhe merren të gjitha masat dhe aktivitetet për gjetjen e veturës dhe vozitësit pjesëmarrës në këtë aksident trafiku.

Gjoba për 15 vozitës, i parkuan gabimisht veturat

Stacioni policor për siguri në komunikacion në Tetovë ka vazhduar me aktivitetet për siguri më të madhe në rrugët e Tetovës, lidhur me parkimin e gabuar në pjesën qendrore të qytetit edhe atë në rrugët "Ilinden", "Iliria", "Bllagoja Toska" dhe "29-nëntori". Të enjten janë zbuluar dhe në mënyrë adekuate janë sanksionuar 15 vozitës, të cilët veturat e tyre i kanë parkuar në mënyrë të parregullt. Vozitësve u janë përgatitur parashtresa adekuate, kështu që veturat janë ngritur nga ana e karrotrecit. Aktivitete të këtilla dhe të ngjashme me këto janë të planifikuara deri në fund të këtij muaji, gjegjësisht gjatë muajve të verës, kur edhe pritet rritja e intensitetit të veturave në trafik nëpër rrugët e Tetovës. Gjithashtu gjatë ditës së enjte, janë zbuluar 4 vozitës fillestarë, 2 vozitës të cilët kanë drejtuar automjetin pa patentë shoferi dhe një vozitës që ka drejtuar veturën nën ndikim të alkoolit. Këto dhe shkelje tjera të konstatuara janë rrumbullaksuar me 10 fletëpagesa për kundërvajtje dhe 11 fletëpagesa të detyrueshme për kundërvajtje. *(U.H)*

EKSPERTË GREKË VIZITOJNË SHKUPIN

RIPËRTËRIHET BASHKËPUNIMI NË MBROJTJE ME GREQINË

Komodor Majkëll Naum, në emër të delegacionit grek, theksoi se bisedimet e shtabit nuk janë burokratike, por proces thelbësor i avancimit të bashkëpunimit në mbrojtje. Ai ka thënë se edhe Armata e Greqisë është e gatshme t'i realizojë planet për thellim të bashkëpunimit me Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shkup, 15 mars - Një delegacion i Ministrisë së Mbrojtjes së Greqisë i kryesuar nga komodori Majkëll Naumov në Shkup realizoi takim me ekipin ekspert nga Ministria e Mbrojtjes, i kryesuar nga koloneli Zoran Sekullovski. Me këtë rast, u bisedua për thellimin e bashkëpunimit në mbrojtje mes dy vendeve, i cili, siç u vlerësua në katër vitet e kaluara ishte në nivel modest. Avancimi i bashkëpunimit, siç kumtoi Ministria e Mbrojtjes, është inicuar nga ministrat e mbrojtjes të dy vendeve, Shekerinska dhe Apostolakis, në takimin muajin e kaluar në Bruksel.

Ekipi i Greqisë, dje u prit në takim tek zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska, e cila ka shprehur kënaqësi nga gatishmëria e mbrojtjes së dy vendeve, të tregojë në vepër se Marrëveshja e Prespës i hap mundësitë për bashkëpunim, në interes të qytetarëve. "Vendimi i dy qeverive është që ta përforcojmë bashkëpunimin, t'i ndërrojmë raportet mes dy vendeve dhe t'u japim mbështetje dhe miqësi. Diskutimi transparent dhe dinamik për thellimin e bashkëpunimit të dy delegacioneve tregon se armatat janë të parat që u përgjigjën në thirrjen politike që t'i hapin mundësitë për bashkëpunim në interes të qytetarëve nga dy vendet - fqinj. Kanali i bashkëpunimit është i hapur, duhet ta kompensojmë kohën e kaluar", potencoi në takim ministrja e Shekerinska.

Komodor Majkëll Naum, në emër të delegacionit grek, theksoi se bisedimet e shtabit nuk janë burokratike, por proces thelbësor i avancimit të bashkëpunimit në mbrojtje. Ai ka thënë se edhe Armata e Greqisë është e gatshme t'i realizojë planet për thellim të bashkëpunimit me Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas drejtimit të ministrit Apostolakis, ndërsa në interes të dy vendeve fqinje. Potencoi se edhe potenciali për bashkëpunim është i madh. Nga Ministria shtojnë se dy ministrat janë pajtuar se bashkëpunimi do të intensifikohet në plan dypalësh, rajonal dhe në kuadër të NATO-s. Pas këtij takimi, ministrja ka dërguar ftesë deri te kolegu i saj grek Apostolakis, e cila pritet që të realizohet së shpejti. Kjo do të jetë vizita e parë zyrtare në një vizitë zyrtare, të ministrave të mbrojtjes të dy vendeve, pas 16 viteve.

"Titanik 3" nis nga fillimi me dëgjimin e "bombave"

Shkup, 15 mars - Gjykimi për lëndën "Titanik 3" në të cilin akuzohen Ejup Halimi dhe Ismet Guri, për shkak se si anëtarë të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Çair në zgjedhjet lokale në vitin 2013 "kanë shkatërruar materiale zgjedhore", do të vazhdojë më 17 prill. Në seancën e djeshme për herë të tretë filloi procesi gjyqësor për këtë lëndë të PSP-së, me nxjerrjen e dëshmive materiale, më saktësisht me dëgjimin e bisedave të "bombave". Prokurori Gavrill Bubevski kërkoi pajtueshmëri nga të akuzuarit dhe mbrojtja që të mos përsëritet nxjerrja e dëshmive materiale, që tanimë dy herë janë nxjerrë para këshillit të mëparshëm gjyqësor. Kërkoi që e gjithë ajo të përcillet në procesverbalin e kaluar me çka, siç tha nuk do të përsëritej. Të akuzuarit nuk u pajtuan me propozimin e prokurorit dhe vazhdoi nxjerrja e dëshmive materiale. Njëra prej bombave u dëgjua se si dy persona bisedojnë për zgjedhjet, ku njëri i thotë bashkëbiseduesit të votojë për Strumicën për shkak se do të jetë e nevojshme edhe për Çairin. Bubeski prezantoi raporte në Këshillat zgjedhore nga zgjedhjet lokale në vitin 2013 që përmbajnë rezultate të përmbledhura për zgjedhjen e kryetarit të Komunës së Çairit, që siç tha prokurori, të dukshme janë korrigjimet e dokumenteve që tregojnë se si nuk duhet të mbahen procesverbale.

Shkup, 13 aksidente për 24 orë

Shkup, 15 mars - Gjatë 24 orëve të fundit në Shkup janë sanksionuar 27 shoferë për shpejtësi, pesë kanë qenë nën ndikim të alkoolit, 13 para se të marrin të drejtën për drejtimin e automjetit dhe dy fillestarë, tregojnë të dhënat e buletinit të SPB-së Shkup. Gjatë ditës së djeshme në Shkup kanë ndodhur 13 aksidente rrugore, në dy prej aksidenteve lëndime të lehta trupore kanë marrë dy shoferë dhe një bashkudhëtar, në shtatë aksidente nëntë persona kanë marrë lëndime të lehta trupore, ndërsa në katër aksidente ka pasur dëme materiale. Policia rrugore ka dhënë 116 dënime për parkim të parregullt, ndërsa me automjetin special të karrotrecit janë ngritur 89 vetura. Nga komunikacioni janë përjashtuar gjashtë automjete të paregjistruara dhe dy teknikisht të parregullta. Në ngjyrën e kuqe kanë kaluar dy shoferë, dy shoferë nuk kanë dhënë leje për kalim të këmbësorëve në vendkalimet e këmbësorëve, 10 shoferë për reshtim të parregullt, një shofer për parakalim të parregullt, një shofer nuk ka dhënë përparësi për kalim të automjeteve në zonën e udhëkryqit, dy shoferë nuk kanë mbajtur rrip të sigurimit dhe 23 kanë përdorur telefonin celular.



Rritja ekonomike e Ballkanit bëhet trend

Shkup, 15 mars - Perspektiva ekonomike pozitive e Ballkanit Perëndimor është e pakontestueshme, ndërsa rritja mesatare e BPV në vitin 2020 pritet të jetë afër 4 për qind. Këtë në Sarajevë e deklaroi sekretarja e përgjithshme e Këshillit Rajonal për Bashkëpunim, Majlinda Bregu, në takimin e Bordit të organizatës, e cila është lloj të trupit operativ të vendeve të Procesit për Bashkëpunim në Evropën Juglindore (PBEJ), themelues i të cilit është edhe Republika e Maqedonisë së Veriut.
"Rajoni shënon progres dhe ka perspektivë ekonomike pozitive. Në vitet paraprake rajoni realizonte rritje të pandërprerë ekonomike, me ç'rast analistët pajtohen se ky trend do të vazhdojë edhe në afat të mesëm, ndërsa parasheh se trendi do të përforcohet dhe se në vitin 2019 rritja mesatare do të jetë 3,5 për qind, derisa në vitin 2020 ai do të arrijë 3,8 për qind", deklaroi Bregu. Ajo shtoi se sfidat e ardhshme do të jenë gjithnjë e më të mëdha. "Është reale të pritet se programi për punë të Bashkimit Evropian do të ketë ndikim edhe në procesin e zgjerimit të vet me Ballkanin Perëndimor. Njëkohësisht do të kontrollohen kredibiliteti dhe gatishmëria e Ballkanit Perëndimor t'i përmbushë kriteret dhe të bashkëngjitet drejt BE-së", tha Bregu. Këshilli ka qenë i informuar se Bosnja e Hercegovina e ka ndërmarrë kryesimin me PBEJ-në dhe se në vijim janë përgatitjet që Kosova ta ndërmarrë kryesimin e ardhshëm, kumtoi sot KRB.

BASHKËPUNIM I VOGËL I INVESTITORËVE TË HUAJ ME KOMPANITË VENDORE

BASHKËPUNIM QË MATET ME PESHOREN E FARMACISË

"Edhe pse kohët e fundit shënohet një trend përmirësimi i këtij bashkëpunimi falë edhe masave qeveritare stimuluese, megjithatë e tërë kjo varet nga vullneti i mirë i palëve që nuk është obligues. Bile, na mungon një model i tillë ku në bazë të subvencioneve që ju ofrojmë investitorëve të huaj dhe që i paguajmë ne si taksapagues, do të përcaktohej edhe niveli i bashkëpunimit prej 2, 3 apo 9 për qind", thotë Angelevski

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 15 mars - Bashkëpunimi i kompanive vendore dhe investitorëve të huaj që punojnë në Zonat ekonomike është aq i vogël dhe i papërfillshëm saqë mund të matet me peshoren e farmacisë. Nga Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë thonë se niveli tejet i ulët i bashkëpunimit të ndërsjellë mund të përmirësohet vetëm një angazhim të përbashkët të bizneseve vendore dhe investitorëve të huaj si dhe shtetit.

"Nevojitet që të dyja palët të angazhohen më fuqishëm që të rritet niveli aq i ulët i bashkëpunimit që nëse flasim si vlerë përkundër të dhënave të ndryshme statistikore, është aq i vogël saqë mund të matet edhe me promil farmaceutike. Edhe pse kohët e fundit shënohet një trend përmirësimi i këtij bashkëpunimi falë edhe masave qeveritare stimuluese, megjithatë e tërë kjo varet nga vullneti i mirë i palëve që nuk është obligues. Bile, na mungon një model i tillë ku në bazë të subvencioneve që ju ofrojmë investitorëve të huaj që i paguajmë ne si taksapagues, do të përcaktohej edhe niveli i bashkëpunimit prej 2, 3 apo 9 për qind", thotë anëtari i Këshillit drejtues të Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë, Trajan Angelevski.

Sipas tij, kompanitë e huaja me menaxhment më cilësor janë të interesuara më shumë për bashkëpunim me kompanitë vendore.

"Ne, si biznese vendore nuk i dimë nevojat për furnizime të investitorëve të huaj, ku për shembull, mund të theksoj si shembull pozitiv kompaninë BALFIN, e cila edhe pse ligjërisht nuk është e obliguar, ajo i shpall publikisht furnizimet e saja publike", shton Angelevski.

Më tej, ai shton se bankat në shtet duhet të kenë një marrëdhënie më të ngushtë bashkëpunimi me kompanitë vendore që kërkojnë kredi për të investuar në prodhimtari.

"Bankat vendore ju kërkojnë kompanive vendore si sigurim apo kolateral, patundshmëri dhe nuk pranojnë makineritë si garanci për kthimin e kredisë. Kjo nënkupton që për 100 makina, për shembull, kërkohen 100 banesa si garanci", shton më tej Angeleski.

Nga Lidhja e Odave Ekonomike ankohen se sfidë për kompanitë vendore në të ardhmen mbetet edhe përgatitja më e madhe materiale, teknike, kadrovike, trajnimet si dhe ngritja e cilësisë së prodhimtarisë, ndërsa si shtet nevojitet që angazhim më i madh edhe për sigurimin e kuadrit të nevojshëm teknik që del nga shkollat e mesme.

Nga ana tjetër, drejtori i Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë, Aleksandar Zarkov thotë se anketat kanë treguar se vetëm 4 për qind e bizneseve janë pjesë e zinxhirit të vlerës së zonave të lira ekonomike, 6 për qind sigurojnë një lloj shërbimi, dhe 13 për qind kanë ndonjë lloj të bashkëpunimit apo bashkëpunojnë me investitorët e huaj, ndërsa bile 59 për qind nuk kanë dhe nuk ndërmarrin n asnjë masë konkrete që të tejkalojnë një situatë të tillë.

"Kompanitë e mëdha kanë përqindjen më të lartë në zinxhirin e vlerës të kompanive në zonat e lira ekonomike me 10 për qind, ndërsa tek kompanitë e vogla kjo përqindje është maksimalisht 5 për qind. Njëherazi kompanitë e mëdha marrin pjesë me 10 për qind në logjistikën e tyre. Nga kjo mund të konstatohet se bizneset e mëdha janë partner që mund të sigurojnë mallra dhe shërbime me kohë dhe cilësi standarde, për dallim prej 99.7 për qind të kompanive të vogla dhe të mesme që kanë resurse të kufizuara për bashkëpunim me kompanitë në zonat ekonomike", thotë drejtori Zarkov. Në ndërkohë, ekzekutivi me më shumë masa angazhohet që të rritet bashkëpunimi ndërmjet kompanive vendore dhe të huaja , duke rritur ndihmën për mbi 250 kompani vendore për blerjen e teknologjisë përkatëse. Njëherësh, në analizën e tyre Instituti ekonomik, Fajnens Think rekomandon masa për procesin e standardizimit, stimulimin e prodhimtarisë së lëndës së parë si dhe uljen e mëtejshme të kompensimeve doganore dhe thjeshtësimin e procedurave doganore për import në favor të rritjes së bashkëpunimit midis kompanive të huaja dhe vendore.

BEKTESHI TAKIM PUNE ME MATEO LUIXHI BJANKIN

HYRJA NË NATO SIGURON STABILITETIN E SHTETIT

Shkup, 15 mars - Agjenda për reforma ekonomiken të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke i përfshirë sfidat dhe mundësitë që ajo i ofron, ishte në fokus së takimit punues të ministrit të Ekonomisë Kreshnik Bekteshi dhe anëtarëve të delegacionit të Nënkomitetit për tranzicion dhe zhvillim të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, të udhëhequr nga zëvendëskryetari Mateo Luixhi Bjanki, e cila ishte për vizitë dyditore në Republikën e Maqedonisë së veriut, informojnë nga Ministria. Ministri Bekteshi theksoi se hyrja në NATO i siguroi stabilitet dhe siguri shtetit që kontribuoi për rritje ekonomike të investimeve prej mbi 624 milionë euro, prej të cilave pjesë më e madhe janë nga BE-ja, SHBA-ja dhe Turqia, që i hap dyert për vende pune të reja dhe mirë të paguara, rritje të standardit të jetesës dhe rritje graduale ekonomike. delegacioni ka treguar interes për sektorët prioritar të cilëve u është dhënë rëndësi e veçantë në periudhën e ardhshme dhe që do të thotë përparim, ekonomi të fuqishme dhe perspektiva të reja për të rinjtë. Sipas Bekteshit, në fokus të vëmendjes janë energjetika, industria dhe investimet, ndërsa duke marrë parasysh faktin që Republika e Maqedonisë së veriut është vend i vogël, anëtarësimi në asociacione të mëdha do të thotë stabilitet ekonomik dhe politik, që reflektohet në të gjitha fushat e jetesës.

Bekteshi shprehi falënderim për vizitën e Nënkomitetit për tranzicion dhe zhvillim të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, e

cila realizohet në një periudhë të rëndësishme për vendin tonë, kur tashmë tetë vende anëtare të NATO-s e kanë ratifikuar Protokollin për anëtarësim të plotfuqishëm të Maqedonisë së veriut, duke shfaqur mbështetje për perspektivat tona euroatlantike, theksohet në kumtesën e Ministrisë së Ekonomisë. *(Z.V)*

Komisioni i Venecias e përshëndeti ligjin për Këshillin Gjyqësor

Shkup, 15 mars - Komisioni i Venecias, në seancën e djeshme plenare në të cilën mori pjesë edhe ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska, e përshëndeti mendimin për Ligjin për Këshillin Gjyqësor, me çka vlerëson se është arritur nivel i lartë i harmonizimit me ligjet tjera. "Komisioni i Venecias e shpjegoi mendimin e tij për Ligjin e propozuar për Këshillin Gjyqësor, të cilin e vlerëson si legjislacion me cilësi të lartë, gjegjësisht se me ligjin është arritur nivel i lartë i harmonizimit me ligjet e tjera", kumtoi Ministria e Drejtësisë. Komisioni i Venecias, siç thekson Ministria, përsëri kishte vlerësim pozitiv për reformat në gjyqësor dhe harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare. Në sesion është theksuar bashkëpunimi i mirë i ministres Deskoska me Komisionin e Venecias, si dhe gatishmërinë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut që shpejtë t'i zbatojë rekomandimet e Komisionit të Venecias. Komisioni i Venecias me kënaqësi theksoi se janë respektuar një numër i madh i rekomandimeve të cilat ishin dërguar deri te Ministria e Drejtësisë, qëndron në kumtesë.

"Vlerësimi gjithëpërfshirës mundëson që të arrihet përfundim se dispozitat e draft ligjit janë shumë shpesh në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe nëse interpretohen dhe zbatohen në besim të mirë, mund të sigurojnë pavarësi dhe efikasitet të gjyqësorit. Komisioni kishte edhe fjalë lavdëruese edhe për qartësinë e kornizës juridike", thekson Ministria. Pozitivisht janë vlerësuar kriteret e reja për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor. Krahas ndryshimeve të tjera pozitive të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, në raportin e Komisionit të Venecias rekomandohet që edhe testet psikologjike më të mos përdoren gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, me çka ulet mundësia për ndikime politike gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit. Rreth zgjedhjes për kryetar të Këshillit Gjyqësor, Komisioni i Venecias rekomandon që ai të zgjidhet me shumicë prej dy të tretave nga radhët e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të zgjedhur nga Kuvendi.

ANTIKORRUPSIONI PËR RESPEKTIMIN E LIGJIT ANTIKORRUPSION

GJASHTË KRYETARË NUK E KANË PARAQITUR PASURINË

Pesë kryetarë të komunave, theksoi ajo, kanë parashtruar vetëm deklaratë për interes, me ç'rast nuk është shënuar për çfarë është parashtruar e njëjta, nëse për kryetar, apo për ndonjë funksion tjetër

Shkup, 15 mars - Gjashtë kryetarë të komunave nuk kanë parashtruar Listë anketuese për gjendjen pronësore dhe deklaratë për interes, deklaroi kryetarja e Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit Biljana Ivanovska, pas kontrollit të kryer që Komisioni e ka kryer në evidencën e tij për kryetarët e komunave. Pas zgjedhjes së funksionit, gjashtë kryetarë të komunave nuk kanë dorëzuar Listë anketuese për gjendjen pronësore dhe deklaratë për interes, edhe atë Milikije Halimi, kryetare e Komunës së Haraçinës, Isen Shabani, kryetar i Vrapçishtit, kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, u.d. kryetari i Ohrit Konstantin Georgievski, i Komunës së Tearcës, Isen Asani, si dhe kryetari i Komunës së Sopishtës, Stefçe Tërpovski.

"Shtatë kryetarë të komunave në afatin e paparë me ligj pas marrjes së funksionit nuk kanë parashtruar vetëm deklaratë interesi, ndërsa kanë listë anketuese, edhe atë Albon Xhemaili, kryetar i Komunës së Bogovinës, të Komunës së Bosilovës Zoran Zimnakov, të Vasilevës Marjan janev, të Komunës së Dellçevës Goran Trajkovski, të Novo Sellës Boro Stojçev, tlë Studeniçanit Azem Sadiki dhe të Komunës së Çashkës Goran Stojanovski", deklaroi kryetarja e KSHPK Biljana Ivanovska.

Pesë kryetarë të komunave, theksoi ajo, kanë parashtruar vetëm deklaratë për interes, me ç'rast nuk është shënuar për çfarë është parashtruar e njëjta, nëse për kryetar, apo për ndonjë funksion tjetër edhe atë, Sasho Jankovski, kryetar i Komunës së Vevçanit, të Gazi Babës Boris georgievski, të Komunës së Dollnenit Xhemil Qamili, Jordan nasev i Komunës së Karbincit dhe Arija Ibrahim i Komunës së Qendër Zhupës. Ibrahimi, i cili është rizgjedhur në funksionin, gjithashtu ka parashtruar vetëm listë anketuese dhe deklaratë për interes me ç'rast nuk është theksuar për çfarë është parashtruar e njëjta, nëse për ndërprerje apo për zgjedhje. Kundër tij do të parashtrohet procedura kundërvajtëse, ndërsa gjoba është prej 200 deri në 400 euro. Lidhur me kontrollimet e rasteve për nepotizëm, siç tha Ivanovska, janë marrë dokumente nga institucionet prej ku kanë kërkuar. "Do të kërkojmë edhe të dhëna shtesë dhe tani vijon përpunimi i atyre dokumenteve", tha kryetarja e KSHPK. *(Z.V)*

Sindikata kundër MASH-it

Shkup, 15 mars - Sindikata e Pavarur për Arsim dhe Shkencë (SPASH) reagon që është ndryshuar kalendari i punës në shkollat fillore dhe të mesme, gjegjësisht sepse dita e sotme dhe e shtuna e ardhshme janë shpallur ditë pune në arsim. "Edhe pse vitin e kaluar, kur punuam madje pesë të shtuna, MASH deklaroi se kanë konfirmuar që punimi gjatë ditëve të shtuna është joefikase dhe se nuk do të praktikohet në të ardhmen, këtë vit vazhdohet me praktikën e njëjtë joefikase. Madje, kompetentët nuk e marrin parasysh se ditët në të cilat nxënësit u liruan nga mësimi për shkak ndotjes enorme të ajrit, ishin ditë pune për të gjithë të punësuarit në arsim", deklaroi Valentina Mishkova-Kenkova, sekretare e përgjithshme e sindikatës. Nga Sindikata thonë se gjatë sjelljes së vendimit të tillë nuk është marrë parasysh se në vijim janë një numër i madhe garave komunale dhe rajonale të cilat mbahet të shtunave dhe se me mbajtjen e mësimit të shtunave do të krijohet kaos nëpër shkolla.

Një ligj për zhvillim të shpejtë të sipërmarrjes sociale

Shkup, 15 mars - Në Maqedoni dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, sipërmarrja sociale është në zhvillim. Akoma nuk ka përkufizim se çka është sipërmarrja sociale as kornizë ligjore që e rregullon këtë çështje. Për dallim prej nesh, në Bashkimin Evropian rreth 10 për qind e ekonomisë e përbëjnë pikërisht ndërmarrjet sociale që janë zhvilluar në dekadat e kaluara. "Sipërmarrësia sociale në Maqedoni është në zhvillim. Ajo ka për qëllim t'i nxisë aktivitetet ekonomike që kanë vlerë sociale respektivisht që zgjidhin probleme të caktuara shoqërore, siç është problemi me papunësinë, veçanërisht të personave të kategorive më të prekura" tha Marija Risteska drejtoreshë ekzekutive e QHKP-së, duke shtuar se më pas këto sipërmarrësi sigurojnë edhe shërbime sociale plotësuese të nevojshme për bashkësinë.

Ajo thotë se edhe pse ka vullnet politik dhe mbështetje të caktuar financiare, që për ndërmarrjet shoqërore jepet në kuadër të masave aktive për punësim, megjithatë është e nevojshme kornizë ligjore e cila do e rregullojë këtë çështje që të mundet këtë lloj sipërmarrje ta zhvillohet. "Të gjitha masat financiare dhe politike për mbështetje janë të mjaftueshme, nuk ka kornizë ligjore për sipërmarrësi sociale për shkak se nuk mund të përcaktohet se cila kompani apo organizatë është sipërmarrës social dhe në bazë të asaj duhet të jetë shfrytëzues i këtyre shërbimeve, potencoi Risteska në përfundimin e ngjarjes së projektit "Smart Start. Ndikimi i qëndrueshëm i organizatave të qytetarëve nga Maqedonia, Bosnja e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Turqia përmes sipërmarrjes sociale dhe inovacioneve sociale.

Ajo thotë se ekziston vullnet te pushteti që kjo çështje të rregullohet dhe shpreson se ajo së shpejti do të ndodhë dhe ky lloj ligji do të sillet. Shtoi se ekziston edhe vullneti që të ndryshohet edhe sistemi i furnizimeve publike dhe përqindja e caktuar të dorëzohen nga ndërmarrjet sociale. Damir Zekoviq nga BeH, i cili është koordinator rajonal i projektit potencoi se vendet e Bashkimit Evropian tanimë me dekada punojnë me këtë model dhe korniza ligjore që e mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve sociale.

Nga e diela temperatura t mbi 20 gradë

Shkup, 15 mars - Për fundjavë dhe në fillim të javës së ardhshme pritet mot i ngrohtë me rritje të temperaturave ditore.
Të dielën dhe në ditët e para të javës vijuese në pjesën më të madhe të vendeve temperatura ditore do të arrijë mbi 20 gradë celsius.

Llogari bankare për familjarët e viktimave të Llaskarcës

Gostivar, 15 mars - Këshilli i Komunës së Gostivarit ka miratuar unanimisht në seancën e 12-të vendimin për hapjen e një Llogarie të posaçme bankare në të cilin mund të donohen mjete për ndihmë të familjarëve të viktimave dhe të lënduarve në tragjedinë në afërsi të fshatit Llaskërcë.

"Xhirollogaria do të jetë e hapur për një kohë të pacaktuar, ndërsa për ditën e mbylljes së saj vendim do të marrë Këshilli i Komunës së Gostivarit. Varësisht nga mjetet e grumbulluara, Këshilli do të vendosë edhe për mënyrën dhe lartësinë e mjeteve të cilat do tu ndahen të pësuarve.

Gostivarasit dhe qytetarët e Maqedonisë në përgjithësi, gjithmonë kanë ditur të tregohen humanë dhe solidarë.

Ta dëshmojmë edhe kësaj here humanizmin tonë dhe të ndajmë dhembjen dhe humbjen bashkë me të pësuarit në tragjedinë më të madhe që goditi Gostivarin!", thuhet në vendimin e Këshillit të Komunës së Gostivarit.

Arben Agolli, kandidat i ASH-së për kryetar të Dibrës

Dibër, 15 mars - Aleanca për Shqiptarët më 21 prill në garën për kryetar të Komunës së Dibrës do të marrë pjesë me doktorin Arben Agolli, pediatër i njohur. Kjo, ashtu siç citohet në kumtesën e degës partiake, është vendosur në Kuvendin e mbrëmshëm të degës së partisë në Dibër.
"Në Kuvendin zgjedhor në prani të 59 prej 65 delegatëve njëzëshëm për kandidat të kryetarit të komunës së Dibrës ishte zgjedhur dr. Arben Agolli. Paraprakisht, për aktivitetet e degës së Dibrës për periudhën mes dy kuvendeve raport dorëzoi Ilirjan Fetahu, kryetar i degës, derisa për gjendjen aktuale në vend dhe vlerën e zgjedhjeve të dyfishta ka folur Surija Rushiti, deputet në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut nga radhët e Aleancës për Shqiptarët", citohet në kumtesë.
Agolli ishte në garë për kryetar të komunës së Strugës edhe në zgjedhjet lokale të kaluara në vitin 2017, kur në rrethin e dytë me rezultat të ngushtë ishte zgjedhur Ruzhdi Lata për kryetar komune, i cili pas një kohe të shkurtër nga sëmundja e rëndë vdiq në nëntor të vitit të kaluar.

MËNYRA E GABUAR E JETESËS

PO RREZIKOHET SHËNDETI FIZIK E MENDOR I FËMIJËVE

Një nxënës që është i përfshirë në aktivitete sportive ka më shumë gjasa të mos vuaj nga stresi. Prandaj, rëndësia e edukatës fizike në shkollë nuk qëndron vetëm në dobitë e aktivitetit fizik, por edhe në përfitimet e tjera, sidomos në arritjen e vetëbesimit

Koha — Delvina KËRLUKU

Shkup, 15 mars - Në të kaluarën fëmijët e shfrytëzonin kohën e lirë në ambiente të hapura, me aktivitete fizike e lojëra të ndryshme. Kjo mënyrë e të jetuarit krijonte parakushte për një shëndet stabil, si në pikëpamje fizike ashtu edhe në atë psikike. Kjo ishte edhe arsyeja që fëmijët kishin zhvillim harmonik të trupit, pa deformime dhe çregullime të tjera anatomike.

Por, si është sot gjendja me shëndetin e fëmijëve?

Mënyra se si fëmijët sot jetojnë, lë shumë hapësirë për devijime të shumta, në radhë të parë të natyrës fizike. Qëndrimi gjatë kohë para kompjuterit, abstenimi nga aktiviteti fizik, kequshqyerja, ose ushqimi i gabueshëm, kanë bërë që fëmijët sot në të shumtën e rasteve të duken me pamje që nuk korrespondon me moshën e atyre. Zakonisht ata duken të kërrusur, të ngathtë dhe jorrezistues ndaj viruseve të ndryshme sezonale që përhapen. Madje edhe kur shoqërohen me moshatarët e tyre, lojërat kthehen me kompjuter. Por, sa mendohet që kjo mënyrë e gabuar e të jetuarit të korrigjohet, në mënyrë që fëmijët të gëzojnë një zhvillim normal shëndetësor. Sipas mjekëve, deformimet trupore të fëmijëve përbëhen prej dy faktorëve, njëri është faktori gjenetik dhe e i dyti - përdorimi pa limit i pajisjeve teknologjike.

"Dëmtimet trupore si pasojë e faktori gjenetik është i predisponuar të zgjerohet edhe më shumë nga përdorimi i tepërt i telefonave, kompjuterëve, etj. Shqetësues është fakti se në periudhën dhjetë vjeçare numri i defekteve trupore te fëmijët është shumëfishuar. Kjo është edhe arsyeja e vizitave mjekësore nëpër shkolla, të njohura si kontrolle sistematike, ku edhe detektohen problemet akute, me të cilat pastaj duhet të merret sistemi shëndetësor. Rekomandohet që sëmundjet dhe komplikimet e ndryshme të parandalohen duke i kontrolluar fëmijët me kohë, por të gjitha këto të shoqëruara me aktivitete fizike", thotë ortopedi Ismalaki Klenja, për gazetën KOHA. Disa nga përfitimet e shumta që vijnë prej edukatës fizike ndërlidhen me mbajtjen e peshës së shëndetshme, parandalimin e sëmundjeve kronike dhe mësimin e shkathtësive të nevojshme. Rade Ilieski, mësues i edukatës fizike, thotë se stili i jetesës moderne bën që fëmijët tanë të mos jenë fizikisht aktiv.

"Qëndrimi para kompjuterit ose tabletit shkakton deformim të shpinës, shtrembërime dhe deformime të ndryshme që nga mosha më e hershme. Nga ana tjetër, fëmijët vuajnë edhe nga problemet me sy, për shkak të varshmërisë nga monitori i kompjuterit ose televizorit. Për pasojat e shkaktuara nga rrezatimi prej tyre unë nuk dua të flas, është e qartë. Prandaj, si një profesor i vjetër i edukimit fizik dhe shëndetësor, por edhe si një trajner me kohë të gjatë të notit, sugjeroj që fëmijët të merren me më shumë sporte, dhe sidomos me notin. Noti, pozitivisht ndikon në zhvillimin e përgjithshëm të individit, aktivizon sistemin e frymëmarrjes dhe sistemin kardiovaskular, vë në lëvizje krejt trupin dhe forcon të gjithë muskujt", thotë Ilieski.

Mjekët, por edhe mësuesit mendoj se fondi prej tri orëve i edukimit fizik dhe shëndetësor që zakonisht praktikohet në shkollat tona, nuk është i mjaftueshëm. Ata rekomandojnë që ky fond të rritet, të paktën pesë orë në javë, në mënyrë që ushtrimet në sallë dhe në oborr të shkollës të ndikojnë në mbajtjen e kondicionit fizik e mendor të fëmijëve. Një nxënës që është i përfshirë në aktivitete sportive ka më shumë gjasa të mos vuaj nga stresi. Prandaj, rëndësia e edukatës fizike në shkollë nuk qëndron vetëm në dobitë e aktivitetit fizik, por edhe në përfitimet e tjera, sidomos në arritjen e vetëbesimit.

Konfirmon BP, rritja e ekonomisë arrin në 2.7 për qind

Shkup, 15 mars - Rritja reale e ekonomisë vitin e kaluar, sipas të dhënave të Bankës Popullore, ka qenë 2.7 për qind dhe ishte më i lartë se sa pritej me parashikimet e tetorit për 2.3 për qind. "Të dhënat e vlerësuara zyrtare të BPV-së për tremujorin e katërt të vitit të kaluar tregojnë rritje të qëndrueshme ekonomike prej 3.7 për qind në bazë vjetore, që është më e lartë se sa pritej me parashikimet e tetorit. Nga aspekti i strukturës së rritjes, performancat më të mira shpjegohen kryesisht nga rritja më e lartë e konsumit personal dhe publik në lidhje me pritjet e parashikimeve. Në përputhje me pritjet, investimet bruto gjithashtu kanë rritje, megjithëse pak më të ulët se që ishte e parashikuar. Vëzhguar me vitin 2018, rritja reale e ekonomisë ishte 2.7 për qind dhe është më e lartë se sa pritej me parashikimet e tetorit për 2.3 për qind", thuhet në raportin më të ri të Bankës Popullore. Në dy muajt e parë të vitit, norma mesatare vjetore e rritjes së çmimeve të konsumit ishte 1.1 për qind dhe është më e ulët krahasuar me parashikimin e tetorit. Vlerësimet për lëvizjen e shumicës së çmimeve të importit në periudhën e ardhshme kanë ndryshuar në drejtim të ulët. Në kushte të tilla, raportojnë nga Banka Popullore, rreziqet e normës së parashikuar të inflacionit për vitin 2019 prej 2 për qind dhe aktualisht vlerësohet si në rënie. Sa i përket zhvillimeve monetare, të dhënat monetare fillestare për muajin shkurt tregojnë rritje mujore në dispozita dhe kredi, me lëvizje të favorshme nga aspekti i monedhës dhe strukturës së sektorit. Likuiditeti i bankave vazhdon të rritet, ndërsa aktiviteti në tregun e depozitave ndër bankare është relativisht i ulët. Paraja e tepërt e lirë është ridrejtuar në dispozita në dispozicion me Bankën Popullore, e cila siç shpaloset nga Banka, siguron fleksibilitet të lartë dhe disponueshmëri të fondeve për mbështetjen e qetë të kredisë për subjektet vendore. *(Q.A)*

57 porosi miqësie për shtetësinë

Nga Suzana SALIU

Shtetësia paraqet lidhjen juridike në mes personit dhe shtetit dhe nuk e përcakton përkatësinë etnike. Ashtu si i përkasim familjes dhe shoqërisë ashtu i përkasim edhe shtetit, me atë që pajisemi me dokumentin e shtetësisë. Nga ky dokument burojnë një varg të drejtash dhe obligimesh që na bëjnë të ndihemi pjesë e shtetit ku jetojmë. Vetëm përmes shtetësisë krijojmë marrëdhënie legale me shtetin. Ndryshe, jemi ilegal dhe të përbuzur.

Mospasja e shtetësisë është një problem i vjetër dhe shumë serioz me të cilin ballafaqohen një numër i madh i qytetarëve të Maqedonisë të cilët edhepse kanë lidhje të forta dhe efektive me vendin nuk e gëzojnë këtë të drejtë. Problemi u bë më se evident pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Zyra e Avokatit të popullit pothuajsë çdo ditë pranon ankesa të kësaj natyre.

Procedura për aplikim të shtetësisë gjithandej paraqet një procedurë komplekse, burokratike dhe rigorozisht të përcaktuar me ligj. Maqedonia që nga viti 1992 ka Ligjin për shtetësi, i cili ne mënyrë të avancuar është ndryshuar disa herë. Në të gjitha shtetet e Europës procedurat për shtetësi udhëhiqen nga parimet dhe standardet e përcaktuara në Konventën Europiane për shtetësi, e cila që moti është bërë pjesë edhe e sistemit juridik të vendit duke u ngërthyer në Ligj. Por, gjatë procedurave shpesh këto standarde dhe parime jo vetëm që vihen në lojë por edhe shkelen nga ana e organeve të Ministrisë së punëve të brendshme, sidomos nga shërbimi sekret i kësaj Ministrie.

Rasti që e ka motivuar këtë shkrim është i rëndësishëm, absurd, por edhe sensibilizues. Një qytetar nga Serava, i cili ka lindur në Shkup në vitin 1962, vite me radhë me organet e Ministrisë së punëve të brendshme që vendosin për të drejtën e shtetësisë, po zhvillon beteja të njëpasnjëshme për marrjen e shtetësisë. Nga procedura në procedurë. Jeton në Shkup në vazhdimësi, në shtëpinë e përbashkët familjare, me gruan, fëmijët madhor dhe nipat. Pra, ka lidhje shumë të forta me vendin. Të gjithë anëtarët e familjes gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Maqedonisë, përveç kryefamiljarit. Për ti përmbushur kushtet ligjore për aplikim, qytetari i Seravës, ka qenë i obliguar që paraprakisht të pajiset me letërnjoftim për të huaj, me të cilin dokument dëshmon qëndrimin e tij legal. Është paraqitur si i huaj në adresën e shtëpisë së tij ku me familjen jeton vite me radhë. Ose, siç thotë gazetari, "i huaj në shtëpinë e vet".

Është e pakuptueshme dhe absurde që qytetari nga Serava këtyre ditëve humbi edhe një betejë me organet e shtetësisë, në një fazë kur flasim dhe po punojmë intenzivisht në reformimin e shërbimeve sekrete e veçmas edhe në reformimin e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim. U refuzua sërish, për shkak se kjo Drejtori sërish, "vlerëson" se pranimi i qytetarit nga Serava në shtetësinë e Maqedonisë e rrezikon sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë. Aktvendimi i fundit i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i datës 11.03.2019 nuk përmban arsyetim se pse personi në fjalë është "armik" dhe i "rrezikshëm" për shtetin, edhe përkundër obligimit ligjor se shkaqet duhet të arsyetohen. (Neni 7 paragrafi 1 pika 8 e Ligjit për shtetësi). Është e drejtë e pakontestueshme e qytetarit nga Serava, por edhe e familjes së tij që të njihet me "veprimtarinë armiqësore" të kryefamiljarit. Qytetari nga Serava ka 57 vjet dhe dërgon 57 porosi për miqësi, dhe asnjë për armiqësi. Porosi të njëjtë dërgon edhe e moshuara 70 vjeçare, poashtu nga Shkupi e cila që nga viti 1964 me familjen e saj e jeton në Shkup. Ajo nuk pranon dhe nuk bindet që të nxjerrë letërnjoftim për të huaj. Nuk pajtohet që në shtëpinë e saj të paraqitet si "mysafire". Të njëjtin problem me shërbimet sekrete e ka edhe edhe 40 vjeçarja po nga Shkupi, nënë e dy fëmijëve të mrekullueshëm, shtetas të Maqedonisë, e të cilën shërbimet e sigurisë në mes tjerash e kishin pyetur që të ilustrojë para tyre "si i lutet zotit". Me qindra porosi për miqësi deri te shërbimet sekrete të Maqedonisë.

Qytetari i Seravës, edhe pse ka lindur para 57 viteve në Shkup, nuk pranohet në shtetësinë e Maqedonisë sepse, Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim, për të satën herë, pa kurrfarë arsyetimi e etiketon si të rrezikshëm për mbrojtjen dhe sigurinë e vendit. Rasti dërgon 57 porosi për miqësi dhe asnjë për armiqësi.

Reformat nuk bëhen me ndryshimin e emërtimit të shërbimeve sekrete. Reformat duhet ti kërkojmë në mentalitetin, kulturën dhe qasjen e atyre që udhëheqin dhe punojnë në këto shërbime.

Një gjë është e sigurt. Personat në fjalë dhe shumë të tjerë që po zhvillojnë betejë për të drejtën e shtetësisë, nuk janë "azilantë" por, një kategori historike në shtetin Maqedonisë dhe ky shtet duhet tu del zot. Këta persona, Maqedonia nuk guxon "ti fusë në një thes" me kategorinë e re të të huajve, të ardhur si emigrantë dhe refugjatë nga Siria ose shtete tjera të përfshira me luftë e varfëri. Është fjala për qytetarë që shtëpi të vetme e kanë Maqedoninë. Nuk kanë ku të shkojnë. Kjo duhet të jetë pikënisja.

Avokati i Popullit në vazhdimësi, vite me radhë, apelon deri te organet e Ministrisë së punëve të brendshme që vendosin për të drejtën e shtetësisë për një trajtim sa më human dhe sa më fleksibil ndaj kësaj kategorie historike të qytetarëve të cilët duhet ta gëzojnë këtë të drejtë shumë të rëndësishme. Është në interesin nacional të Maqedonisë që këta njerëz të jenë shtetas të saj. Lum ai vend që ka shumë miq.

(Autorja është zëvendëse e Avokatit të Popullit)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha Epërditshme informative www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premte,15 mars 2019 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Thaçi, sprovë e drejtësisë

Nga
Daut DAUTI

Nuk e kam menduar se do të vijë një ditë që të bëhem apologjet i ndonjë politikani. Apologjia e politikanëve sikur nuk kuptohet drejtë nga lexuesit edhe kur ndoshta mund t'i mbrosh me të drejtë. Nuk e di nëse lexuesit pajtohen me këtë. Mbroj parimin se më shumë duhet të merremi me fenomenet se me personat, më shumë me idetë dhe me veprat se me kriterin e simpatisë. Dorën në zemër, këto nuk janë gjëra që mund të ndahen kollaj, sepse, shpesh pas një dukurie qëndron një person dhe anasjelltas, ndaj dhe krijohen simpatitë ose antipatitë. Por, publiku ynë shpesh vuan nga simpati/antipatomanija, dhe shpesh nuk i shikon veprat por merren merret me personin, pa i analizuar gjërat në parim. Do të ishte normale që të shkruhet në mënyrë kritike për bartësit e dukurive, por jo dhe të jemi kritik vetëm pse dikush nuk na pëlqen për arsye (simpatishë) partiake.

KUR DREJTËSIA MERR NË THUA...

Ndoshta në mbamendjen e lexuesve mund të jem dukur se kam qenë më tepër kritik ndaj veprimit politik të PDSH-së dhe udhëheqësve të saj, e në veçanti për Menduh Thaçin. Kur kam thënë e kam shkruar diçka, kam qenë i bindur se kam qenë objektiv dhe nuk bëhem pishman për këtë. Mund të mos pajtoheni gjithnjë, por ky është këndvështrimi. Shumëkush mund të mos kujtojë dhjetë vjetët e fundit të kem shkruar as mire as keq, edhe pse ndoshta është dashur. Jam përmbajtur për shkak të pozicionit që kam pasur.

Këtë hyrje e bëj që t'i jap alibi vetës që të shkruaj për mospajtimin tim me dënimin prej 3 vjetësh për Menduh Thaçin për shkak të "porosisë" së tij drejtuar anëtarit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (Bedredin Ibrahimit)për të ndihmuar VMRO-në në Strumicë. Jo pse tash kam ndërruar dhe jam i afërt me qëndrimet politike, ose se dua ta përkrah veprimin që ka bërë. Jo. Natyrisht, jam kundër votimit të porositur në KSHZ nëpërmjet bashkëpartiakut të tij, sepse është thjeshtë një shërbim ish-partnerit të koalicionit, një solidaritet që çon në vendim arbitrar në KSHZ. Dhe, me sa mbaj mend, në "kriterin" e përgjigjes pozitive ndaj ish-shefit të DSK-së, kur ai ka kërkuar këtë shërbim, është një lojalitet ose solidaritet apriori, e jo ngase vërtetë janë bërë shkelje të procesit zgjedhor. Dhe një element plotësues që e ka shtyrë bashkapartiakun e liderit të PDSH-së për të votuar sipas kërkesës së ish shefit të DSK-së, ka qenë inati ndaj partisë rivale shqiptare, që "ia ka vjedhë" votat PDSH-së në një komunë tjetër...Vota është e pacënueshme dhe thelbi i demokracisë dhe kush e shkel atë duhet të marrë dënimin e merituar. Vendimi i anëtarit të PDSH-së me porosi nga lartë mund të jetë një cenim, por për këtë nuk mund të jem kategorik, sepse nuk jam organ hetues që ta di tamam çka ka ndodhur në Strumicë, për të cilat vota po përpiqet PSP-ja ta djegë edhe liderin e PDSH-së bashkë me disa të tjerë. Por, unë, megjithatë, në këtë rast jam me Menduh Thaçin dhe jam kundër vendimit të gjyqit, i cili mund t'i kishte faktet për një vendim të tillë. Me gjyqin jam nëse ai mbron drejtësinë dhe votën e pacenueshme të qytetarit. Sepse, përfundimisht, duhet ta marrin porosinë të gjithë ata "të fortë" që i fusin në zjarr aktivistët më të ulët partiakë për t'i kryer ndonjë shërbim partisë duke rrezikuar të hanë burgun. Jam për atë që edhe të fortët ta marrin porosinë se nuk munden më të kërkojnë diçka për çka dikush do të digjet. Në këtë mënyrë, shtrohet përgjegjësia dhe lojaliteti ndaj shtetit ligjor...Kjo sidomos si mësim për të ardhmen dhe për shtimin e besimit në institucione. Dënimi i tyre e ka këtë porosi dhe duhet të merret seriozisht.

> **Disa prej të akuzuarve për terrorizëm, të cilët nevojiteshin për të votuar, nga burgu i Shutkës i çuan në Parlament dhe ata fituan përfundimisht lirinë. Edhe Menduhi ka votuar për ndryshime kushtetuese, pse ata të tjerët të lirohen dhe ky të përfundojë në burg? Aq më tepër që nga porosia telefonike e Menduhit askush nuk ka përfunduar me kokë të çarë dhe në komë siç përfunduan disa të gjakosur ose të tërhequr zvarrë të pajetë pas hapjes së dyerve të parlamentit nga ana e deputetëve të liruar!**

Por, te ky vendim ndaj Menduh Thaçit, Bedredin Ibrahimit, Sasho Mijallkovit dhe disa anëtarëve tjerë të KSHZ-së, çuditërisht e kam patjetër të jem në anën e tyre, jo për shkak të tyre, por për shkak të parimit. Sepse nuk bëhet më fjalë për drejtësi, por për mosdrejtësi...Shumëçka që ka ndodhur kohëve të fundit, na shtyn të mendojmë se sa i padrejtë mund të jetë një "vendim i drejtë"("pajtimi" ose falja për 7 prillin) nëse në një shtet nis të veprojnë kutet e ndryshme të drejtësisë. As një javë pas vendimit për lëndën "Titanik 2", gjyqi sjell një tjetër vendim, me të cilin djali i një deputeteje, në vend se me burg, dënohet vetëm me kusht! Rastësish ose jo, djali është i deputetes e cila iku nga koalicioni parazgjedhor i VMRO-së për t'iu bashkangjitur 80 votave për ndryshime kushtetuese. Pa dëshmi është vështirë të gjykojmë, por nuk jemi aq naivë të mos supozojmë se në negocimin e votës së saj për ndryshimet kushtetuese(për ndërrimin e emrit), ka qenë pikërisht lirimi i djalit të saj... Dalëngadadalë gjërat e prapaskenës po dalin në shesh dhe sigurisht do të dalin edhe më edhe për disa persona të tjerë që s'kanë lidhje me faljen e 27 prillit, e janë në rrugë e sipër t'i ikin përgjegjësisë për vepra të caktuara.

Nuk jam për dënimin e Thaçit edhe ngase kohë më parë nga dënimi disavjeçar me burg u liruan personat që ishin akuzuar për vepër terrorizëm dhe rrezikim të rendit kushtetues. Dënimi për këtë lloj vepre është më i madh se maksimumi që mund të merrte Menduhi ose Bedredini. Disa prej të akuzuarve për terrorizëm, të cilët nevojiteshin për të votuar, nga burgu i Shutkës i liruan për të shkuar drejt në Parlament dhe ata fituan përfundimisht lirinë. Edhe Menduhi ka votuar për ato ndryshime, pse ata të tjerët të lirohen dhe ky të përfundojë në burg? Aq më tepër që nga porosia telefonike e Menduhit askush nuk ka përfunduar me kokë të çarë dhe në komë siç përfunduan disa të gjakosur e të tërhequr zvarrë të pajetë pas hapjes së dyerve të parlamentit nga ana e deputetëve!

Nuk e parapëlqej përsëritjen e qëndrimeve në shkrime, por këtë ta imponojnë rrethanat. Ndaj dua të theksoj me plot bindje se Menduhi është viktimë e defektit që polli falja selektive. Me atë falje selektive gjithkush më e ka të qartë se u lëkund në themel shteti juridik, sepse me kritere politike u zgjodhën një kategori njerëzish që do të faleshin, sepse për shërbimin e tyre kishte nevojë momenti historik e politike(pra, votimi i ndryshimeve kushtetuese), ndërkohë që u lanë të tjerë të "shijojnë" forcën e drejtësisë. Por, parimi i së drejtës nuk funksionon në mënyrë selektive. Nëse bëhet presedent që të lirosh dikë nga veprat me ndërhyrje politike në gjyqësi, atëherë hapi më i drejtë është që zbatimi i ligjit të mos jetë në mënyrë selektive. Për fat të keq, kjo qasje selektive do të prodhojë viktima tjera edhe pas Thaçit e Bedredinit, sepse ka disa lëndë të ngjashme ku vjen në shprehje kuti i dyfishtë. Sepse në çdo hap parimi i drejtësisë po vihet në sprovë. Nëse telefonatat e përgjuara ishin dëshmi për veprën e Thaçit, gjyqi në disa raste të tjera, incizime të ngjashme nuk i mori parasysh si dëshmi. Opozita e tashme vazhdon ta përdorë këtë argument. Me të drejtë. Sepse përderisa "digjen" opozitarë e kursehen të tjerë, atëherë cila është poenta të vazhdohet me lëndë të këtilla. Në rastin e lëndës së Thaçit, gjyqësia bie ndesh edhe me parimin e përgjegjësisë së organeve kolektive. Vendimin e KSHZ-së e kanë vërtetuar dy gjykata(nuk po hyj nëse e kanë bërë me të drejtë ose jo), gjykatësit e të cilave nuk kanë kurrfarë përgjegjësie për shkak të imunitetit, ndërkaq Bedredini me shokë, si pjesë e atij organi kolektiv, që përgjigjet vetëm para parlamentit, të merren në përgjegjësi penale. Aq më tepër, ngase ky vendim i KSHZ-së nuk ka pasur ndonjë ndikim në rezultatin zgjedhor.

Prandaj, edhe unë që nuk jam shquar si fan i filozofisë politike të Menduhit, sot jam me Menduhin dhe Bedredinin dhe e përkrah pa rezervë heqjen e dënimit ndaj tyre, për një vepër shumë më beninje se disa vepra të tjera, për të cilat u liruan kryesit, sepse për ta kishte nevojë shteti në një moment kyç, për çka dhe e flijoi drejtësinë. Shteti sot ka nevojë edhe për Menduhin deputet, sepse ka dhënë kontribut jo më pak se të liruarit tjerë deputetë në këto ndryshime kushtetuese dhe në reformat e nevojshme për eurointegrimet.

Madje jam dhe kundër që e gjithë kjo të jetë bërë edhe si skenar që në fund të lirohet me ndonjë arsyetim në shkallën tjetër gjyqësore. Sepse nga ky lloj teatri nuk kemi nevojë, por ajo që ka nevojë, është korrektësia dhe sinqeriteti ndaj qytetarëve. Prandaj me ngulm mbroj qëndrimin që nëse tashmë është shkelur parimi i mosndëshkimit, atëherë le të shkohet gjer në fund, që parimi të vlejë njësoj për të gjithë dhe pa teatralitete(siç është kur dikush herë futet, e herë e nxjerrin nga paraburgimi, varësisht nga "rrethanat" e nevojës!).

PSP LE T'I VAZHDOHET MANDATI PAS FALJES JO SELEKTIVE

Javën që po lëmë pas, shënoi një zhvillim interesant edhe sa i përket fatit të Prokurorisë Speciale. Kryeministri Zaev dhe lideri i opozitës, Mickovski, u takuan dhe u morën vesh që të punojnë bashkë për fatin e Prokurorisë Speciale Publike përmes dy grupeve punuese që do t'i harmonizojnë qëndrimet në të ardhmen për rregullativën ligjore që do ta zgjidhte edhe statusin e PSP-së. Pavarësisht se insistohet që ndryshimet ligjore të bëhen para zgjedhjeve presidenciale, një gjë e tillë duket se është jo reale, por me rëndësi është që pushteti dhe opozita të punojnë në një çështje që është parakusht për reformat në drejtësi.

Mirëpo, nuk do të kishte sukses reforma nëse së pari nuk pastrohet në pikëpamje principialiteti çështja e lëndëve si kjo e Menduh Thaçit ku duket qartë se drejtësia ka marrë në thua dhe me rëndësi të veçantë është që të shfrytëzohet momenti që të vihet një rend në trajtimin e veprave. Mendimi im është që prokuroria të shndërrohet në një organ i cili do të kishte autorizime të ndjekë veprat e korrupsionit dhe keqpërdorimet nga pozitat e pushtetit, diç që ende funksionon në Rumani që është makth për pushtetarët. Por, ky pozicion i ri për PSP-në do të duhej të vlente pas një zbatimi joselektiv të faljes(e cila u mbyll si shpejtë, duke lënë të hutuar edhe ekspertë edhe opinionin publik). Ndoshta në fund të mandatit mund të kyçet në në lojë edhe një herë nënshkrimi i Gjorge Ivanovit dhe të marrë fund kjo maskaradë politiko-juridike. Ma merr mendja se edhe ai do të donte të lironte ndonjë nga përkrahësit e tij nga partia që e solli në pozitën e shefit të shtetit!

Marrëveshja për një fillim të mund të ishte një model i faljes(në njërën anë) dhe ndalimit për t'u marrë me veprimtari politike gjithë aktorëve që janë pjesë e "bombave" të famshme dhe që gjyqi ka konstatuar keqpërdorime. Fill pastaj do të duhej t'i jepeshin kompetencat e reja PSP-së që të vazhdojë luftën kundër korrupsionit dhe anomalive tjera që lidhen me pushtetin.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

KOHA e lirë 123

shtojcë enigmatike e fundjavës

FJALËKRYQI KLASIK



HORIZONTALISHT: 3. Aktori amerikan, Gregori; 5. Njësia monetare e Japonisë; 7. Legjenda e futbollit kosovar, Vokrri; 9. Ish futbollisti i kombëtares, Cana; 10. Qetësim; 12. Kryerje e një pune; 13. Mbledhje, ku shqyrtohen çështje të rëndësishme; 15. Endacak; 16. Lloj gjysëmmajmuni afrikan; 18. Kompani koreane automjetesh; 20. Kopjim i origjinalit; 23. Rritje e menjëhershme ekonomike; 24. Qytezë afër Shibenikut, Kroaci; 26. Ish boksieri sudanez, Mohamed; 28. Jo i bardhë; 29. Këngëtarja amerikane, Melani (fituese në "X-Factor 2011"); 30. Ndajfolje; 31. Poeti shkodran, Siliqi; 33. Emri dhe mbiemri i regjisorit shqiptar ("Kohë e largët", "Shirat e vjeshtës"); **41. Mbiemri i prezantueses në foto;** 42. Mjedisi që na rrethon; 43. Fillimi i agimit; 44. Vajzat; 47. Qëndisje me bedena, ojara; 48. Qytet në Japoni; 49. Zatet.

VERTIKALISHT: 1. Shtresa e perlës (guaska); 2. Nobelisti ynë, Murad; 3. Pastër; 4. Kryeqyteti i Ekuadorit; **5. Emri i prezantueses në foto;** 6. Minder; 8. "Mbreti" i Shekspirit; 9. Shprehje që përdoret për një njeri të lumtur; 11. Sopranoja jonë, Mula; 12. Dera; 14. Aktorja amerikane, Uest; 15. Shifra; 17. Shumë i imët; 18. Shtet në Amerikën e Mesme; 19. Hoxhë; 21. Futbollisti algjerian, Uali; 22. Insekti i bezdisshëm; 23. Bariumi; 24. Vargu; 25. Nikeli; 27. Kartonat; 30. Shënoj poen; 32. Inicialet e basketbollistit Parker; 33. Banjë mjekuese; 34. Pagesa ditore; 35. Lloj druri; 36. Rimini; 37. Bashkëtingëllore e zanore; 38. Përemër vetor; 40. Ushtria republikane irlandeze; 45. Ndërtimet mbi lumë; 46. Perëndia romake e dashurisë.

Kakuro

5x5 dhe 6x6

Kakuroja është kombinim i fjalëkryqit dhe Sudokut. Në vend të shkronjave shënohen numra edhe atë prej 1 deri 9. Numrat nuk duhet të përsëriten as horizontalisht e as vertikalisht. Numrat brenda fushave duhet t'i japin shumat, të cilat janë dhënë në skajet e fushave që duhet të plotësohen.





mini FJALËKRYQI

Plotësojeni fjalëkryqin sipas figurave të dhëna!

KOHA e lirë
për më të rinjtë

Labirinti

Ndihmojini lepurushit të dalë nga mali!

30 dallimet

Gjejini dallimet te këto dy fotografi!



Fshehësira

Ku fshehen figurat e dhëna?

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "*është më i madh se*".



KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.



ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!



NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.



mini SKANDI me anagrame

Anagramet e mëposhtme japin dy poezi të autorit strugan në foto.

Anagrami 1
(Poezi)

TË LINDI TREVA

Anagrami 2
(Poezi)

KE BALOSHIN MIK, BIR (R=L)

MENSUR MAMUTI	ANAGRAMI 1 (PJESA E DYTË)	KLUB I TOPOLËS	PREFIKS GREK PËR "I HUAJ"	ANAGRAMI 2
PARAARDHËSE E RUMUNEVE				
FAT, KËSMET				
KOMPANI SUEDEZE E MOBILJEVE				
AZOTI / NDAJFOLJE, SIGURISHT		NDRE MJEDA / POHIM ANGLEZ		

KOHA E LIRË	POETI YNË NË FOTO	KRYEQYTETI I JORDANISË	LLOJ QEFULLI, BUZAÇ / PËRKËDHEL, LEDHATOJ					
ANAGRAMI 1 (PJESA E PARË)							OZONI / GRUP KËNGËTARËSH	
LUMË MES RUSISË DHE KINËS					RRJETË PESHKIMI / FLORI			
VIZATIM I VENDEVE TË BOTËS						NONDA BULKA / AKTORI AMERIKAN, FLIN		
KAMATA								
TEMPERATURA		ITRIUMI / PRIJËSI I KOZAKËVE			ROYAL ARCTIC LINE / VARG NJERËZISH NË VIJË TË DREJTË			
FAMË				POPULL ME HISTORI, GJUHË E KULTURË / I BIRI I MBRETIT VAROSH 1				
KALË SHALE			KËNGËTARJA AMERIKANE, KALLE / NOVELISTI SLLOVEN, KOMEL					
SHALË DRURI						Ë. L. / LLOJ DEMONI I FOLKLORIT JAPONEZ		
FSHAT NË KUMANOVË								
TITULL I MBRETËRVE NË EGJIPTIN E LASHTË							NORVEGJIA / METRI	
NDRYSHIMI I ZËRIT NË MELODI, INTONACION								KOHA E LIRË

Sudoku

i lehtë

		8	5		2	4		
	2			3			7	
6			8					9
8					3	7		6
	4						5	
1		7	6					2
5					7			4
	7			9			6	
		4	3		6	1		

mesatar

		7	6	1		5		
						6	3	
								2
5								7
	4			9				
7		9			3	4		5
		4				2	1	
2		5		3		7	6	
	6		9					

i vështirë

6		9			7	3		
					8			
	1		6		4			2
	6	8						
	3		4					8
	5				3		7	
	7			6	5	1		
4			1					
								6

	6		2	9			1	
9		5	7			6		3
	2				6		9	
		2					4	5
4			9		3			6
6	5					3		
	8		3				5	
7		6			5	4		8
	1			4	9		6	

			7	6				
		1			3	4		
						8		3
				9	4			
8							5	9
		9				1		
		5	2				8	
	2		6			5	1	
	8			1		7		

2								3
			2	3	9			
		5		1		7		
	7		8		5		3	
	9	1				8	5	
	5		9		1		7	
		6		2		5		
			7	8	4			
7								8

KRIPTOGRAMI i kombinuar

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
							D												

1	2	3	4	5	6	5	■	7	2	8	7	4	9
10	8	6	5	11	6	■	6	11	12	2	8	13	14
15	4	3	2	10	■	15	11	6	8	6	■	14	4
2	11	6	■	7	11	4	12	7	6	14	2	■	16
						12	4	12	2	13	14	2	■
						6	17	■	3	18	13	18	2
						14	4	19	■	6	9	6	15
						5	8	4	20	■	12	5	4

J	B	DH	B	RR	DH	■	DH
B	O	DH	K	DH	■	B	RR
M	■	SH	TH	G	B	M	J
J	C	■	S	DH	G	B	SH

LL	B	RR	J	DH	M	C	B	K	■	RR	DH	SH	E
DH	M	DH	B	■	J	B	M	B	U	B	RR	NJ	■
J	B	RR	SH	B	■	K	NJ	O	J	SH	B	K	J
B	RR	J	B	M	J	■	RR	DH	B	J	SH	J	LL

Fjalëkryqi i parë plotësohet sipas rregullit ***"numri i njëjtë - shkronja e njëjtë"***, ndërsa fjalëkryqi i dytë sipas rregullit ***"shëno shkronjën fqinje"***. P.sh. në fushën ku është shkronja K, duhet të shënoni J ose L. Në fushat e hijezuara do të fitoni emrin dhe mbiemrin e autorit tonë në foto.



RUSËT, SPIUNAZH AKTIV NË SHQIPËRI

Historia e aktivitetit te spiunazhit rus në Shqiperi, është e hershme. Prej vitesh, diplomat të kësaj ambasade në Tirane kanë kërkuar të rekrutojnë për fushën e Mbrojtjes

Historitë, të paktën ato të dokumentuara, nisin në vitin 1998, kur Atashe Ushtarak i Ambasades Ruse në Tiranë, emërohet Igor Sergun. Një ushtarak karriere, i nderuar me shume dekorata në vendin e tij Sergun shërbeu në Shqipëri, në periudhën e luftës së Kosovës. Në vitin 2011, Sergun dekretohet nga Vladimir Putin në krye të GRU-së, Shërbimit Informativ të Ushtrise Ruse. Detyrë të cilën ai e mbajti deri me 3 janar 2016, ditë në të cilen ai vdiq. Vdekje, e cila u mbulua me mister dhe ku u aludua shumë mbi shkaqet.

Por historia vazhdon. Vizion Plus ka siguruar 4 dokumente të viteve 2005 – 2007, të cilat jane të deklasifikuara tashmë, ku tregohet roli i shërbimeve ruse, por jo vetëm. Në keto informacione janë të përfshira dhe sherbimet malazeze dhe ato serbe. Por deri me sot janë deklasifikuar vetëm shkresat përcjellese, jo informacioni i transmetuar në to.

Shkresa e parë e datës 8 Mars 2005, e firmosur nga kreu i Shërbimi Informativ te Shtetit të kohës, Bahri Shaqiri dërgon materialin me temë: "Aktivitetet aktuale të shërbimeve sekrete serbe, malazeze dhe ruse ndaj Shqipërisë", informacion ky i kërkuar nga Zyra e e Sigurisë e NATO-s. Me pas ky dokument, i cili ende vijon të jetë i klasifikuar, i përcillet Ambasadorit te Shqipërisë në NATO në atë kohë, Ilir Boçka, për ta dërguar atë prane zyres së Sigurisë së NATO-s.

Por dukumenti i cili hedh dritë mbi aktivitet spiunazhi nga përfaqësues ushtarak rus ndaj Forcave të Armatosura të Shqipërisë, mban datën 2 maj 2007 dhe është firmosur nga Ministri i Mbrojtjes i kohës, Fatmir Mediu.

"Që nga viti 2005 e në vazhdim përfaqësues ushtarak të trupit diplomatik rus në Shqipëri zhvillojnë veprimtari në formën e spiunazhit në drejtim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura duke u përpjekur të rekrutojnë individë me akses në informacionin e klasifikuar me qëllim që të sigurojnë informacion mbi informacionin e klasifikuar kombëtar dhe të NATO-s; kapacitetet mbrojtëse të FA; planet e bashkëpunimit me NATO-n dhe vendet anëtare të saj; marrëdhëniet e bashkëpunimit me NATO dhe SHBA; për database të personelit, të hierarkisë ushtarake dhe të emërimeve të ndryshme", thuhet në dokument.

20 ditë më pas, ky informacion i hartuar nga Shërbimi Informativ Ushtarak, i është dërguar ambasadorit tonë në NATO, për ta përcjell atë përsëri në Zyrën e Sigurisë së Aleancës.

Dokumentet edhe pse jo te deklasifikuara plotësisht, tregojnë qartë një interes të Rusise mbi te dhenat e ushtrise shqiptare dhe marredheniet e saj me vendet e tjera te NATO-s. Interes ky, që padyshim është rritur pas antarësimit të vendit tonë në Aleancë. Ky akvititet pritet të jetë akoma edhe me i madh, për shkak se NATO do të ketë edhe bazën e saj ajrore në Shqipëri. Vetëm një ditë më parë kreu i SHISH Helidon Bendo raportoi në komisionin e sigurisë duke dhenë alarmin për rritjen e ndikimit rus në administratën e lartë shtetërore. / *Vizion Plus*

Deputetët e rinj, Basha: U shitën dhe u blenë si bagëti në tregun e Milotit!

Kryedemokrati Lulzim Basha është ndalur sot në Durrë, ku ka zhvilluar një takim me studentë dhe pedagogë për t'i ftuar për një pjesëmarrje masive në protestën e nesërme përpara Kryeministrisë. Basha foli për vendimin e opozitës për djegien e mandateve, duke thënë se nuk mund të rrinin në Parlament me kriminelë si Jurgis Ëyrbja nga PS-ja e Durrësit. "Shqiptarët e kanë marrë vendimin, zot në shtëpinë e tyre nuk do të jenë më as kriminelët, as hajdutët, grabitësit, e as perversët. Deputetet e Durrësit nuk mund te rrinin ne krah te Rrahman Rrajes e Jurgis Çyrbes. Propaganda e Ames se te gjitha janë njësoj ka vdekur, nuk jemi te gjithë njësoj. Ai kanabizioi vendin, e futi ekonominë ne kolaps. Ne kurrë nuk kemi qene me te qarte se kur i dhamë fund fasadës e bashke me te parlamentit te krimit dhe te hajduresise", tha Basha. Ai hodhi akuza të forta në adresë të Vangjush Dakos, duke thënë se dosja e kryebashkiakut të Durrësit i ka kushtuar postin Fatmir Xhafajt si ministër i Brendshëm. Kryedemokrati ka theksuar se "Rama u kap bë flagrancë duke vjedhur vota, ndërsa Vangjush Dako e ka vendin në burg". Ndërkohë, sa i përket kandidatëve për deputetë që dolën "tradhtarë" dhe braktisën aksionin opozitar duke pranuar mandatin, Basha tha se po shiten dhe blihen si në Pazar. "Shikoni si e trajton parlamentin, si banja publike. Shikoni si i trajton deputetët, si bagëti që shiten e blihen si në pazar të Milotit. A ka shenjë më të qartë të degradimit të këtij pushteti, sesa shit-blerja, e të ashtuquajturve deputetëve të opozitës së re si të ishin bagëti", theksoi kreu i opozitës.

Botuesit kosovarë në panairin e librit në Paris, 'Livre Paris'

Botimet më të reja të botuesve kosovarë janë ekspozuar në Paris të Francës, në kuadër të panairit tradicional të librit, "Livre Paris", hapja zyrtare e të cilit u bë mbrëmë, më 14 mars 2019, me praninë e kryeministrit francez, Edouard Philippe.

Në mesin e 515 pjesëmarrësve zë vend edhe shteti i Kosovës, e cila tashmë tradicionalisht, pjesë e këtij panairi me stendën nacionale të Shoqatës së Botuesve të Kosovës

Përveç prezantimit të botimeve, në Paris kanë udhëtuar edhe autorët të ndryshme veprat e të cilëve do të prezantohen gjatë ditëve të panairit, si: Adem Gashi, Ilire Zajmi, Haxhi Kraki e Marigonë Kelmendi, përkthyesi Izet Sylaj etj.

Përmes një njoftimi SHBK-ja bënë të ditur se sivjet e ftuar nderi në panairin e librit në Paris është Evropa. Andaj në kuadër të së ftuarës së nderit është edhe Kosova, me ç'rast prezantohet në debatin e së premtes me autorët e pranishëm.

REAGON AMBASADA E SHBA

Qeveria legjitime, ish-deputetët ta lënë të punojë për të ardhmen

Një ditë para protestës së paralajmëruar nga opozita, ambasada e Shteteve të bashkuara të Amerikës përmes një postimi në faqen saj zyrtare bëjnë thirrje për ruajtjen e qetësisë.

Duke e cilësuar qeverinë dhe Parlamentin aktual si të zgjedhura në mënyrë legjitime, ambasada e SHBA u bëjnë thirrje opozitarëve që dogjën mandatin që ta lënë atë të punojë për të ardhmen e vendit.Në reagimin e ambasadës së SHBA, edhe pse theksohet se ka ende punë për të bërë, vlerësohet ecuria në Reformën në Drejtësi, si dhe përparimin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Deklarata e plotë

Pavarësisht se protesta paqësore është një shtyllë themelore e demokracisë, nxitja apo kryerja e veprimeve të dhunshme, përfshirë edhe shkatërrimin e pronës publike, janë të paligjshme. Ne i nxisim të gjithë aktorët e demokracisë shqiptare që të ushtrojnë vetëpërmbajtje në protestën e 16 marsit.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara i konsideron Qeverinë dhe Parlamentin aktual të Shqipërisë të zgjedhura në mënyrë legjitime nëpërmjet zgjedhjeve të vitit 2017, të njohura ndërkombëtarisht. Ne vlerësojmë punën e mirë që është bërë në zbatimin e reformës në drejtësi në Shqipëri, si dhe përparimin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ka ende punë për të bërë.

Ndërkohë që, ata ish anëtarë të Parlamentit të cilët vendosën të braktisin mandatet, hoqën dorë nga detyrimet e tyre ndaj qytetarëve shqiptarë, duhet të lejojnë ata që duan të punojnë për të ardhmen e vendit të bëjnë punën e tyre.

Ne mbështesim të gjithë ata që vazhdojnë të jenë të përfshirë në procesin demokratik në Parlament, në mënyrë që Shqipëria të vazhdojë të ecë përpara, drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Në manifestin e tij, Tarrant deklaroi se ai kishte planifikuar sulmin rreth dy vjet më parë, por zgjodhi vendndodhjet përfundimtare tre muaj më parë, njoftoi The Sydney Morning Herald

RRËFIMI PËR JETËN E TERRORISTIT BRENTON TARRANT

Terroristi më i madh i Zelandës së Re është paraqitur si djalë i vendit nga New South Wales. Ky është tregimi për jetën dhe pasionet e tij, deri te momenti i sulmit.

Nga një foshnjë me flokë kaçurrela që ndante dashurinë e atit të tij për palestër, në një vrasës masiv të ekstremit të djathtë i cili vrau 49 vetë – jeta e Brenton Tarrant, është zbuluar.

Tarrant, i cili sulmoi një xhami në Al Noor në Christchurch të premten, u rrit në Grafton në rajonin e Rajonit të Veriut të Uellsit të Ri Jugor.Në një manifestim të tronditur prej 73 faqesh të quajtur 'Zëvendësimi i Madh', të cilin ai e shkroi para vrasjeve, 28-vjeçari dha një pasqyrë për edukimin dhe sfondin e tij, shkruan "ABC News".

Me fjalët e tij, Tarrant e përshkroi veten si një 'burrë i zakonshëm, i bardhë', i cili u lind në një klasë punëtore, familje me të ardhura të ulëta skoceze, irlandeze dhe angleze. Ai duket se e ka bërë tregtinë e parave me Bitcoin dhe më pas ka kaluar disa kohë duke udhëtuar në botë në vitin 2017, kur ai vizitoi vendet, përfshirë Korenë e Veriut dhe Pakistanin, si dhe Evropën.

Babai i tij, Rodney, i cili ishte një atlet konkurrues, vdiq nga kanceri në vitin 2010, në mosgën 49 vjeç kurse nëna dhe motra e tij thuhet se ende jetojnë në këtë zonë. Ndërsa mbetet e paqartë nëse ndonjë nga të afërmit e tij – duke përfshirë nënën e tij ende jeton në zonë, familja është shumë e njohur në rajon, njoftoi ABC News.

28-vjeçari shkruan se ai kishte 'pak interes në edukim' duke u rritur dhe nuk kishte ndjekur universitetin pasi nuk kishte interes të madh për çdo gjë që ofrohej në shkolla.Ai pretendoi se kishte bërë disa para duke investuar në Bitconnect – një lloj monedhe dixhitale – para se ai të përdorte paratë për të udhëtuar jashtë shtetit.

AUTORITET SULMIN E SHPALLIN TERRORIST

Policia në Zelandën e Re po vazhdon të monitorojë situatën në Zelandën e Re, ndërsa ashtu sikurse edhe kryeministrja e vendit, edhe ata e kanë konfirmuar se sulmi në Christchurch është terrorist. Përmes një deklarate është konfirmuar se numri i të vdekurve është 49 persona, 41 prej të cilëve janë vrarë në xhaminë në Al Noor, ndërsa 7 në xhaminë Masjid. Një tjetër ka ndërruar jetë në spital. 28-vjeçari Brenton Tarrant është akuzuar për vrasje dhe do të paraqitet nesër në mëngjes në Gjykatën e Rrethit të Christchurch, ndërsa policia është në kërkim edhe të dy tjerëve. Sipas tyre, një i arrestuar tjetër nuk ka të bëjë me këtë sulm. Policia thotë se është ende shpejt për të kuptuar motivet që çuan në këtë sulm, ndërsa hetimet do të vazhdojnë. Ata thanë se do të ketë shtim të numrit të oficerëve në të gjithë vendin për t'u siguruar se të gjitha ngjarjet e paralajmëruara për fundjavë të mbahen.

Tarrant, i cili më vonë do të vazhdonte të bëhej një trajner personal, trashëgoi një dashuri për palestër fizike nga babai i tij, i cili thuhet se vdiq nga një sëmundje e lidhur me asbest. Një grua që pretendon se e ka njohur më parë Tarrantin përmes palestrës, konfirmoi se ishte ai ishte i pasionuar pas stërvitjeve. Trajneri Gray tha se ndoqi një rregjim të rreptë diete dhe stërvitjeje dhe punoi në palestër pasi mbaroi shkollën në vitin 2009 dhe 2001, raportoi "ABC News". Zonja Gray tha se Tarrant gjithmonë 'hodhi veten në trajnimin e tij personal' para se ai më vonë u bë një trajner i kualifikuar dhe filloi të stërviste të tjerët.

Ai ishte shumë i përkushtuar ndaj stërvitjes së tij dhe trajnimit të të tjerëve, tha ajo. Ajo tha se ai ishte shumë i përkushtuar, ai ishte më i përkushtuar se shumica e njerëzve do të ishin.

"Ai ishte në palestër për periudha të gjata kohore, duke ngritur pesha të larta. Ai e transformoi shumë trupin e tij, "tha ajo.

Gruaja gjithashtu tha se nuk i kishte folur atij ose dëgjuar atë të fliste për besimet e tij politike apo fetare."Nga bisedat që kishim për jetën, ai nuk më goditi mua si dikush që kishte ndonjë interes në atë pikëpamje ekstremiste," tha ajo.

"Por unë e di që ai ka udhëtuar që kur ai u largua nga Grafton. Ai ka udhëtuar jashtë shtetit, kurdo dhe kudo", shtoi ajo.

"Do të thosha se është diçka në natyrën e udhëtimeve të tij, diçka që ai ka qenë rreth e rrotull.

"E di që ai ka qenë në shumë vende të ndryshme duke u përpjekur të përjetojnë shumë gjëra të ndryshme në jetë dhe unë do të thoja se diçka ka ndodhur në atë kohë në udhëtimet e tij", tha ajo.

Besohet se Tarrant ka udhëtuar për në Evropë, Azinë Juglindore dhe Azinë lindore.

Në një mesazh të mëparshëm të Facebook në lidhje me një udhëtim në Pakistan në Facebook, ai shkroi: "një vend i pabesueshëm i mbushur me njerëzit më të sinqertë, me zemër dhe mikpritës në botë", raportoi The Sydney Morning Herald.

"Bukuria e luginës hunza dhe nagar në vjeshtë nuk mund të mposhtet". tha ai.

Në manifestin e tij, Tarrant deklaroi se ai kishte planifikuar sulmin rreth dy vjet më parë, por zgjodhi vendndodhjet përfundimtare tre muaj më parë, njoftoi The Sydney Morning Herald.

Ai tha se fillimisht kishte planifikuar të sulmonte një xhami në Dunedin, por u zhvendos në xhamitë e Al Noor dhe Masjid, sepse ata kishin 'shumë më tepër pushtues'. Ai shkroi se si pas sulmimit të këtyre dy xhamive ai planifikonte të shkonte në një xhami në Ashburton, një orë në jug të Chirstchurch. "Unë jam i pasigurt që nga kjo kohë e shkrimit nëse do të arrij këtë objektiv, është një objektiv bonus", shkroi ai.

49 persona besohet se kanë vuajtur plagë me armë zjarri gjatë sulmit, me qindra anëtarë të familjes që ndodhen aktualisht në spitalin e Christchurch.

AUTORITET SULMIN E SHPALLIN TERRORIST

Policia në Zelandën e Re po vazhdon të monitorojë situatën në Zelandën e Re, ndërsa ashtu sikurse edhe kryeministrja e vendit, edhe ata e kanë konfirmuar se sulmi në Christchurch është terrorist. Përmes një deklarate është konfirmuar se numri i të vdekurve është 49 persona, 41 prej të cilëve janë vrarë në xhaminë në Al Noor, ndërsa 7 në xhaminë Masjid. Një tjetër ka ndërruar jetë në spital. 28-vjeçari Brenton Tarrant është akuzuar për vrasje dhe do të paraqitet nesër në mëngjes në Gjykatën e Rrethit të Christchurch, ndërsa policia është në kërkim edhe të dy tjerëve. Sipas tyre, një i arrestuar tjetër nuk ka të bëjë me këtë sulm. Policia thotë se është ende shpejt për të kuptuar motivet që çuan në këtë sulm, ndërsa hetimet do të vazhdojnë. Ata thanë se do të ketë shtim të numrit të oficerëve në të gjithë vendin për t'u siguruar se të gjitha ngjarjet e paralajmëruara për fundjavë të mbahen.

VJEN REAGIMI I FACEBOOK-ut PASI TERRORISTI TRANSMETOI LIVE MASAKRËN

Rrjeti social më i madh në botë, Facebook, ka reaguar menjëherë pas sulmit të sotëm në Zelandë të Re, ku një sulmues la të vdekur 41 persona në një Xhami në qytetin ChristChurch. Përveç ngushëllimeve që kanë dërguar për familjarët e viktimave, Facebook, është zotuar se do të mbyll llogarinë e sulmuesit që e identifikon veten si Berton Tarrent, shkruan, Dailymail.

Kjo pasi që sulmuesi e ishte lidhur drejtpërdrejtë me video në 'Facebook', derisa po e kryente aktin e tmerrshëm.

Përfaqësuesja e 'Facebook' në Zelandën e Re, Maria Garlick, në një email për Bussines Insider ,a shprehur ngushllimet për familjarët.

"Zemrat tona janë sot me viktimat, familjet e tyre dhe komunitetin e prekur nga ky akt i tmerrshëm", ka thënë ajo.

Ajo ka treguar se si Policia kishte njoftuar 'Facebook' pasi kishte parë videon live.

"Policia e Zelandës së Re na alarmoi për një video në facebook, dhe ne shpejt e hoqëm nga llogaritë e Facebook-ut dhe Instagram', ka shtuar Garlick. Ajo ka treguar se janë duke fshirë edhe çfarëdo komenti që bëhet në mbështetje të këtij krimi.

"Ne do të punojmë drejtpërdrejtë me Policinë e Zelandës së Re, pasi hetimet e tyre do të vazhdojnë", ka thënë ndër të tjera ajo.

Sulmuesi kishte pritur ditën e premte për të kryer aktin e tmerrshëm, pasi në këtë ditë myslimanët ishin grumbulluar në Xhami për t'u falur.

Para se të kryente sulmin, në

videot e publikuara, Tarrent kishte dëgjuar këngë të nacionalistëve serb, ku përmendej edhe Radovan Karagjiqi.

LUCIA NADIN: "IKONA E SKËNDERBEUT NË JETËN KULTURORE DHE ARTISTIKE TË VENEDIKUT"

Lucia Nadin ka bërë pjesë të këtij punimi disa sprova të cilat janë maturuar në vite, duke u bërë kështu pjesë të një korpusi studimesh që e gjejnë fillin që i bashkon në një botim si ky i sotmi, duke u bërë njëkohësisht dhe përforcuese të pistave të kërkimit që studiuesja ndjek prej vitesh

Doli nga shtypi "Ikona e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (Nga historia te miti: shekujt XV-XVIII)", nj vepër e re e Prof. Lucia Nadin, botuar n kuadrin e vitit jubilar t sapop rfunduar t 550-vjetorit t vdekjes s Gjergj Kastriotit Sk nderbeut, p rkthyer n gjuhen e shqipe e përgatitur p r botim nga Prof. As. Dr. Evalda Manovi Paci, botuar nga Akademia e Studimeve Albanalogjike, Tiran 2018.

Autorja kishte idenë e një vepre komplekse, që zuri të merrte formë dhe të tematizohej më mirë në proces të përgatitjes për botim, me shënime shpjeguese dhe referenca që sqaronin më mirë qëllimin e saj për t'i shërbyer rindërtimit hap pas hapi të një imazhi që jetoi në shekuj mbi Skënderbeun në Venedik dhe rrethinat e tij.

Studiuesja Lucia Nadin, n k t vep r t re t saj, tregon edhe nj her përkushtimin e saj të veçantë ndaj Shqipërisë dhe historisë s popullit shqiptar, në veçanti ndaj figurës s heroit kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, imazhi i të cilit jeton dhe përmes kësaj vepre q sjell elemente tejet me vlerë.

Lucia Nadin, veneciane, tashmë e ka njohur nga afër Shqipërinë, ku ka kaluar periudha të ndryshme. Më parë ka botuar "Statute e Shkodrës" duke nxjerrë në dritë tekstin nga Biblioteka e Muzeut të Venecies: një "monument" i historisë mesjetare të Shqipërisë. Përmes librit "Shqiptarët në Venedik, mërgim e integrim 1479–1552", aa rindërtuar dukurinë e emigrimit shqiptar në krahinën e Venetos mes shekujve XV e XVI. Ka studiuar traditën ikonografike të Skënderbeut në anijen e dukëve të Venecies, të famshme Bucintoro. Ka punuar mbi mërgimin e klerit katolikë shqiptarë në tokat e Republikës së Përndritur mes shekujve XV dhe XVI. Në vitin 2010 ka marrë titullin e qytetares së nderit të Shkodrës.

Për veprën e Lucia Nadin: Ikona e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (Nga historia te miti: shekujt XV-XVIII) Prof. As. Dr. Evalda Paci shkruan:

Studiuesja Lucia Nadin dëshmon sërish se pasioni dhe përkushtimi ndaj gjurmimit të marrëdhënieve shekullore mes dy vendeve dhe popujve që jetuan në to, hulumtimi i burimeve arkivore që vijojnë të ofrojnë hapësira kërkimi për shumë prej nesh, përforcojnë në një aspekt mjaft pozitiv një kontekst historik që nuk përmbyllet me shekullin që lidhet drejtpërdrejt me Gjergj Kastriotin dhe me emblemacitetin e figurës dhe personalitetit të tij. Siç dhe mund të shihet nga konsultimi i krerëve kryesorë të kësaj vepre, Lucia Nadin ka bërë pjesë të këtij punimi disa sprova të cilat janë maturuar në vite, duke u bërë kështu pjesë të një korpusi studimesh që e gjejnë fillin që i bashkon në një botim si ky i sotmi, duke u bërë njëkohësisht dhe përforcuese të pistave të kërkimit që studiuesja ndjek prej vitesh, duke shpresuar në gjetje të reja dhe në përfundime po aq të denja për të zgjuar kuriozitetin shkencor, në veçanti në lidhje me variante veprash me rëndësi për kohën kur u botuan dhe për një aktualitet që ka të bëjë drejtpërdrejt me studimet albanologjike, me historinë e letërsisë së shkruar shqipe, por dhe me historinë e mesjetës së vonë, duke qenë thirrur në kauzë kësisoj disa linja: historia e shkrimit, historiku i librave të veçantë në të cilat bëhet fjalë shprehimisht për vise dhe figura të rëndësishme për studimet tona në veçanti, bibliofilia si traditë në viset evropiane dhe atyre më afër kontekstit shqiptar, e mjaft elemente të tjera që shtjellohen gradualisht me ecurinë e vetë përmbajtjes që ndërton këtë botim të veçantë". / Vaticannews

Opera "La Boheme", produksioni i parë i TOB për sezonin e ri

Opera "La Boheme" e kompozitorit Giacomo Puccini, e cila do të ngjitet për katër netë me radhë në skenën e Pallatit të Kongreseve, produksioni i parë operistik i Teatrit të Operas dhe Baletit për sezonin janar-qershor 2019

Në fundin e shek. XIX në Paris, katër shokë jetojnë së bashku në një papafingo. Rrobaqepësja Mimi është fqinje e tyre. Njëri nga djemtë poeti Rodolfo, dashurohet me Mimin, e cila vuan nga tuberkulozi dhe do të ndahet nga i dashuri i zemrës…, por kur ndjen se vdekja po i afrohet, ajo shkon drejt dashurisë së saj të vetme, Rodolfos.

Kjo është opera "La Boheme" e kompozitorit Giacomo Puccini, e cila do të ngjitet për katër netë me radhë në skenën e Pallatit të Kongreseve, produksioni i parë operistik i Teatrit të Operas dhe Baletit për sezonin janar-qershor 2019.

""Lindja e këtij produkesioni të ri, është nj proces rigjenereues për TKOB. Ka momente gëzimi, por edhe shumë dyshim, nëse do ja dalim që të realizojmë me sukses produksionin e radhës. Është një proces krijues, jo vetëm në rolin e artistëve, por edhe për stafin e prodhimit. Kjo premierë i është besuar një stafi të ri"- tha Zana Cela.

Regjisorja Ada Gurra edhe artistët pjesëmarrës, e konsiderojnë këtë realizim, si më të rëndësishmin deri më tani në jetën e tyre.

"Shpresoj shumë që t'ua shpërblej të gjithë këtë besim me një shfaqje në nivel të lartë. Me të gjithë solistët, kësaj here kam bërë të pamundurën, që të nxjerrë prej tyre cilësitë më të mira që ata kanë", ka thënë Gurra."Jam e bindur se kjo "La Bohem" do mbahet mend si premiera qe i besoi e promovoi me shume artiste te rinj se asnjëherë tjetër ne historine e këtij Teatri. 90% e stafit protagonist, janë te rinj duke filluar nga regjisorja e deri tek protagonistet e roleve kryesore. Do mbahet mend si produksioni qe ne 4 shfaqet do prezantoje 4 kaste kryesore dhe kjo është e rralle jo vetëm per operat me formate mesatare, sic është teatri ynë, por edhe per teatrot me te madhej ne Europe"- tha Zana Çela.

Ky produksion shënon kulmin e angazhimit të krijuesve dhe artistëve të rinj në një produksion opersitik, të cilët bëhen bashkë me solistët e TOB dhe këngëtarët e ftuar me famë ndërkombëtare. Regjia e operas "La Boheme" i është besuar regjisores së re, Ada Gurra, e cila angazhohet për herë të parë në karrierën e saj, për realizimin e një produksioni operistik të këtyre përmasave. Ndërsa skenografia është realizuar nga Renold Sula.

Orkestra e TKOB do të dirigjohet në katër netët e shfaqjes, më 16,17,18, dhe 19 mars nga dirigjenti italian Lorenzo Tazzieri. (BalkanWeb)

Në Gostivar nxënësit pikturojnë kundër ekstremizmit të dhunshëm

Në sallën e vogël të Qendrës për Kulturë në Gostivar, u shfaq ekspozita me rreth 20 piktura të punuara nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Gostivarit, të cilat trajtonin temën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Ishte kjo një ekspozitë në kuadër të projektit dyvjeçar që realizohet në tre komuna, respektivisht në Gostivar, Çair dhe Kërçovë e që mban titullin "Fuqizimi i qëndrueshmërisë së luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm të komunitetève lokale në Maqedoninë e Veriut", i financuar nga ambasada e Britanisë së Madhe dhe ajo e Holandës.

Dy punimet më të mira të kësaj ekspozite, u shpërblyen me vauçerë prej nga 1000 denarë.

LIGA E PARË - JAVA E 23

VARDARI PËRBALL SHKUPIT, SHKËNDIJA MYSAFIRE E RABOTNIÇKIT

"Jemi të përgatitur maksimalisht dhe jemi të motivuar maksimalisht ndaj Varadarit. Edhe në këtë takim shkojmë për të marrë tre pikët. Deri tani kemi zhvilluar shumë loja të mira dhe qëllimi jonë është të kapet Evropa, ku dhe besoj se jemi afër që të realizojmë qëllimin tonë", deklaroi Filip Ristovski

VARDARI NDALON ARDHJEN E "SHVERCERËVE" NË LAGJEN "MAXHARI"

Sfida mes Vardarit dhe FC Shkupi, në kuadër të javës së 23-të të Ligës së Parë, që do të zhvillohet në stadiumin "Boris Trajkovski" në lagjen Maxhari, është shpallur ndeshje e rrezikut të lartë. Organizatorët e kësaj përballje kanë lajmëruar se biletat për këtë ndeshje mund të blihen vetëm me letërnjoftim, dhe se nuk do të lejohen ardhja e tifozëve mysafirë. Më poshtë është lajmërimi i Vardarit para sfidës me FC Shkupin, që do të zhvillohet të shtunën në orën 14.30.

Koha — Fisnik NUHIU

Shkup, 15 janar - Të shtunën në program do të jenë takimet e javës së 23 në Ligën e Parë futbollistike të Maqedonisë së Veriut. Derbi i xhiros do të zhvillohet në lagjen Maxhari, ku do të përballen Vardari dhe FC Shkupi. Ekipi nga Çairi në këtë përballe hyn pas fitores së madhe ndaj kampionit aktual Shkëndijës javën e kaluar, ndërsa sipas mbrojtësit të FC Shkupit, Filip Ristovski edhe në këtë takim do të futet për të bërë më të mirën dhe se të vazhdohet me serinë pozitive në sezonin pranveror. "Jemi të përgatitur maksimalisht dhe jemi të motivuar maksimalisht ndaj Varadarit. Edhe në këtë takim shkojmë për të marrë tre pikët. Deri tani kemi zhvilluar shumë loja të mira dhe qëllimi jonë është të kapet Evropa, ku dhe besoj se jemi afër që të realizojmë qëllimin tonë", deklaroi Filip Ristovski. Në takimin me Vardarit, trajneri Umut Karan, nuk do të mund të llogaris në shërbimet e Suher Muharremit për shkak të kartonëve të verdhe si dhe Ergin Abdul që është i lënduar. Po ashtu në dyshim është edhe kapiteni Muharrem Bajrami i cili në përballjen me Shkëndijën pësoi lëndim. Nga ana tjetër në qytetin e Tetovës, do të zhvillohet një tjetër takim interesant. Lideri i tabelës Shkëndija do të jetë nikoqire e Rabotniçkit. Shkëndija në fushën e vetë tanimë pesë vite nuk ka pësuar disfatë nga skuadra e Rabotniçkit, kështu që edhe në këtë takim "kuqezinjtë" futen për të marrë fitoren e radhës ndaj "romantikëve".

"Na pret tjetër ndeshje interesante, kësaj radhe përball ekipit të Rabotniçkit për të cilët kemi respekt dhe që rezultatet e fundit të tyre nuk korrespondojnë me cilësinë dhe potencialin që kanë në skuadër. Ne shikojmë punën ton posaçërisht pas ati hapi fals që kishim ndaj Shkupit, tash nuk na lejohet gabim tjetër dhe për këtë aryse jemi të koncentruar të japim më të mirën nga vetja të luftojmë gjithë sëbashku për të nxjerr në fushë atë që kërkon nga ne stafi teknik, dhe për të luajtur në nivelin e dëshiruar të këtij klubi, kampion në fuqi dhe lider, sepse qëllimi për të fituar titullin e kampionit arrihet vetëm kontinuitet, prandaj pres të gjithë të jemi të koncentruar maksimalisht për të marë tre pikë ndaj Rabotniçkit", deklaroi Samir Fazli. Në takimet tjera ekipi i Renovës do të jetë mysafire e Pobedës. Akademija Pandev do të pret Sileksin dhe Makedonija GJ.P do të jetë nikoqire e Bellasicës. Të gjitha takimet zhvillohen ditën e shtunë me fillim prej ora 14:30.

Fenerbahçe insiston për Muriqin

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, në fund të këtij edicioni pritet të largohet nga skuadra e Rizesportit për të vazhduar karrierën te Fenerbahçe. Gazeta e njohur turke "Hurriyet" të enjten ka njoftuar se drejtuesit e Fenerbahçes kanë nisur negociatat me Rizesporin, pasi duan me çdo kusht të transferojnë në radhët e veta Muriqin, i cili po shkëlqen këtë edicion. "Vedat Muriqi pritet të jetë përforcimi i parë i Fenerbahçes për edicionin e ardhshëm. Paraqitjet e tij të mira te Rizespori kanë bërë që drejtuesit e Fenerbahçes të kërkojnë me ngulm transferimin e tij në fund të edicionit", përcjell "Hurriyet". Mësohet se Fenerbahçe është e gatshme të paguajë rreth 1.5 milionë euro dëmshpërblim për shërbimet e tij, pasi Muriqi ka kontratë me Rizesporin deri në verën e vitit 2020. Sulmuesi 24-vjeçar, këtë edicion ka shënuar dhjetë gola dhe ka asistuar gjashtë herë në 25 paraqitje në kampionatin turk. Ai është pjesë e Rizesporit prej janarit të vitit 2018, kur u transferua nga Gençlerbirligi. Muriqi prej edicionit 2014/15 bën karrierë në futbollin turk, pasi ka luajtur edhe te skuadra e Giresunsporit.



MAQEDONIA U21

MILEVSKI PUBLIKON LISTËN E FUTBOLLISTËVE PËR TURNEUN NË TURQI

Shkup, 15 mars - Përfaqësuesja U21 e Maqedonisë këtë muaj prej 18 deri më 27 mars në Turqi do të jetë pjesë e turneut të fortë 'Antalia Kup' në të cilin krahas shpresave të vendit tonë do të marrin pjesë edhe Ukraina U21 (22 mars), Letonia U21 (24 mars), Estonia U21 (26 mars) dhe Kazakistani U21. Vlen të ceket se shpresat e Maqedonisë nuk do të përballen me Kazakistanin për shkak se dy përfaqësueset janë në të njejtin grup në eliminatoret për KE 2021. Pas një viti jo të plotë, Bllagoja Milevski sërish do të drejtojë përfaqësuesen U21 të Maqedonisë. Nën drejtimin e tij shpresat e vendit arritën rezultatin historik dhe kualifikimin në Kampionatin Evropian për të rinjë që në vitin 2017 u mbajt në Poloni. Ajo gjeneratë e futbollistëve të vendit ishte përfaqësuesja e parë në historinë e futbollit të Maqedonisë që ka siguruar kualifikim në mesin e 12-të përfaqësueseve më të mira të Evropës, ndërsa bënë seri prej 12 ndeshjeve pa humbje. Pjesë e madhe e futbollistëve tashmë janë pjesë e përfaqësueses A të Maqedonisë (Enis Bardhi, Deni Iliev, Damjan Shishkovski, Visar Musliu, Egzon Bejtullai, Darko Velkovski, Elif Elmaz, Gjoko Zajkov, Boban Nikollov, Kire Markovski). Ata asokohe ndjenë shijen e hidhur të humbjes 3:0 nga Islanda në start të ciklit eliminator për Euro 2017, ndërsa sollën reagim perfekt me seri fantastike për të zënë vendin e parë në grup para Francës, Islandës, Ukrainës, Skocisë dhe Irlandës Veriore. Ai rezultat, duke llogaritur pritjen e gjatë të Maqedonisë për pjesëmarrje në një garë madhore, u shënua si historik dhe solli besim se futbolli i Maqedonisë sërish do të ketë mundësi të luajë rol të rëndësishëm jo vetëm në eliminatore, por edhe në turnetë përfundimtarë. "Gëzohem për sfidat e reja dhe mundësinë sërish të bashkëpunojmë. Jam i vetëdishëm për situatën që kemi para neve, mirëpo nuk frikësohemi, besojmë te përfaqësuesja, te djemtë dhe do të jemi të gatshëm për sfidat që na presin. Me shumë gjasa kjo do të jetë detyra më e vështira në karrierën time, mirëpo jam këtu, ftesa nga ekipi përfaqësues nuk refuzohet. Kemi cilësi, e dij se mund t'ia dalim dhe nuk do të kisha pranuar këtë detyrë nëse nuk do të besoja te djemtë dhe puna ime. Shpresoj të bëjmë rezultate pozitive", pati deklaruar Bllagoja Milevski, pas emërimit seleksionues i përfaqësueses U21 të Maqedonisë.

LISTA E FUTBOLLISTËVE:

Portierë: Tomas Bozhinovski (Fierense, Portugali), Riste Jankov (Rabotniçki), Daniel Kotevski (Pobeda);
Mbrojtës: Nehar Sadiki (Renova), Agron Rufati (Istra 1961, Kroaci), Esim Liçina (Skopje), Filip Trajanovski (Akademia Pandev), Filip Antovski (Dinamo Zagreb, Kroaci), Mihail Manevski (Akademia Pandev), Todor Todorovski (Osiek, Kroaci), Vane Jovanov (Akademia Pandev);
Mesfushorë: Davor Zdravkovski (AEL Limasol, Qipro), Jani Atanasov (Bursasport, Turqi), Dimitar Mitreovski (Sporting Lisabon, Portugali), Kristijan Ackovski (Rabotniçki), Milosh Toshevski (Zemun, Serbi), Marko Ferukoski (Ofenbah, Gjermani), Besart Shaboviq (Djurgarden, Suedi);
Sulmues: Bejhan Ametov (Borusia Dortmund, Gjermani), Milan Ristovski (Rieka, Kroaci), Mario Krstovski (Akademia Pandev), Daniel Milovanoviç (Akademia Pandev), Kristijan Trapanovski (Slavija Praga, Çeki), Emil Abaz (Breshot, Belgjikë), Erdon Daci (Konjasport, Turqi);

NBA

PËRMBYSJE FANTASTIKE TË NUGGETS DHE CELTICS

Fitore në sekondat e fundit për Denver, që mposhti 100-99 Dallas, ndeshje me rivalitet dhe emocione në fund. Millsap realizoi 33 pikë, vendimtar për triumfin e Nuggets, duke i bërë të pavlefshme 24 pikët e Doncic për teksanët

Denver Nuggets nuk heq dorë nga objektivi për ta mbyllur sezonin e rregullt në vendin e parë të Konferencës së Perëndimit dhe vazhdon të ushtrojë presion ndaj Golden State Warriors. Këtë herë në Pepsi Center vuajti shumë por falë një periode të 4-t fantastike në të cilën arriti të përmbyste plot 12 pikë disavantazh ia doli të mposhte Dallas Mavericks me rezultatin 100-99. Kjo ishte fitorja e 45-të sezonale për Nuggets që numërojnë vetëm një sukses më pak se Warriors. Millsap me 33 pikë 3 asiste dhe 8 rikuperime ishte heroi i padiskutueshëm i Denverit ndërkohë që te miqtë nga Teksasi të cilat i shkuan shumë afër fitores spikati talenti Luka Doncic me 24 pikë 9 asiste dhe 11 rikuperime poshtë tabelës. U rikthye te fitorja Toronto Raptors që në Scotiabank Arena kaloi lehtësisht me rezultatin 111-98 Los Angeles Lakers. LeBron James i vetëm nuk mund të bënte asgjë për të shpëtuar nderin e kalifornianëve që tashmë i kanë djegur të gjitha shanset e tyre për të kapur fazën play-off. 29 pikë realizoi mbreti James në këtë sfidë, ndërkohë që te Raptors më të mirët mbi parket ishin Leonard me 25 pikë dhe Poëell me 20. Paul Goerge shkëlqeu ndaj ish skuadrës së tij duke realizuar 36 pikë në transfertën e Indianapolis ndaj Indiana Pacers, por pavarsisht kësaj Oklahoma u mund nga vendasit me rezultatin e ngushtë 108-106. Një provë force kjo e Indiana Pacers që në këtë sezon është forca e tretë në Lindje pas Bucks dhe Raptors. Një lituanez dhe kroat ishin dy heronjtë e Indianës në këtë duel pasi Sabonis realizoi 26 pikë ndërsa Bojan Bogdanovic shtoi 23 të tjera. Përmbysje spektakolare ishte edhe ajo e Boston Celtics që rikuperoi 17 pikët disavantazh të periodës së dytë për të fituar në fund 126-120 ndaj Sacramento Kings. Thjeshtë magjik Kyrie Irving me një triple-double. Ylli i Celtics koleksionoi në total 31 pikë 12 asiste dhe 10 rebound duke bërë të pavlefshme edhe 34 pikët e Hield për Sacramenton.

Ndahet nga jeta në mënyrë të papritur, tronditet Formula 1

Ka filluar në mënyrën më të keqe të mundshme dhe me një lajm të trishtueshëm kampionati 2019 i Formulës 1. Drejtori historik i garave dhe përgjegjësi i aspektit sportiv dhe teknik të rregullave, Charlie Whiting, është ndarë nga jeta gjatë mbrëmjes së të enjtes. Ka qenë presidenti i F1, Jean Todt, ai që ka dhënë lajmin: "F1 ka humbur një mik besnik dhe një ambasador prestigjioz". I njohur si ai që jep "startin" në çdo garë, Charlie Whiting është ndarë nga jeta në moshën 66-vjeçare për shkak të një embolie në mushkëri, që e ka goditur në gjumë. Ai ndodhej në Melburn për fillimin e sezonit të ri.

Publicitet

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Informacion mbi parashtrimin e kërkesës për qëllimin e realizimit të projektit: Diga me argjinaturë me objektet shoqëruese "Otinja" në komunën e Shtipit

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor informon publikun e interesuar se investuesi Ministria e Bujqësisë, Pyllarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, me seli në rr. "Aminta Treti" nr.2 Shkup, ka dorëzuar një njoftim për qëllimin e realizimit të projektit: Diga me argjinaturë me objektet shoqëruese "Otinja" në Komunën e Shtipit dhe një raportim me të cilin përcaktohet nevoja për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit dhe një listë kontrolli për përcaktimin e fushës së vlerësimit të ndikimit të projektit në mjedis.

Qëllimi i projektit është që të përdorin ujërat e lumit Otinja. Diga e paraparë është e lidhjit të digës me një kanal të papërshkueshëm nga uji prej argjili. Akumulimi i sapokrijuar do të sigurojë furnizim me ujë teknologjik, do të plotësojë sistemin e ujësjellësit për furnizimin e popullsisë me ujë të freskët, duke siguruar një minimum biologjik të garantuar dhe rekreacion të popullatës.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është organi kompetent për vendimmarrje.

Njoftimi i plotë i qëllimit për realizimin e projektit: Diga me argjinaturë me objekte shoqëruese "Otinja" në komunën e Shtipit mund të shihet në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor www.moepp.gov.mk

Personat për kontakt:

Ministria e Bujqësisë, Pyllarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
Bojan Durnev
rr. "Aminta treti" nr. 2, Shkup; tel: + 389 (0) 2 3134 477
e-mail: durnev@zemp.gov.mk

Menka Spirovska DEKONS EMA
m.spirovska@ema.com.mk

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Bulevardi Presveta Bogorodica nr. 3, 1000 Shkup

Biljana Petkoska – Udhëheqëse i Sektorit të Mjedisit Jetësor
Bulevardi Presveta Bogorodica nr. 3, 1000 Shkup
tel: 076 455 427; e-mail: b.petkoska@moepp.gov.mk

Vlatko Cvetanovski - Këshilltar i Departamentit për VNMJ
Bulevardi Presveta Bogorodica nr. 3, 1000 Shkup
tel: 076 455 426; e-mail: v.cvetanovski@moepp.gov.mk

Sfida Wilder-Joshua drejt finalizimit

Sfida e madhe e peshës së rëndë për të unifikuar titujt kampionë bote mes boksierëve Deontay Wilder dhe Anthony Joshua është shumë pranë realizimit. Lajmin e ka konfirmuar Eddie Hearn, menaxheri i Joshua, që shtoi se palët janë pranë marrëveshjes, duke qenë se ky është edhe vullneti i tyre. Joshua mban titujt kampionë bote në kategoritë IBF, WBA dhe WBO, ndërsa Wilder mban titullin e kategorisë WBC. Britaniku Joshua ka konfirmuar se do të mbrojë titujt kampionë bote më 1 qershor, në duelin që do të zhvillojë në Nju Jork ndaj Jarrell Miller. Ndërsa amerikani Wilder pritet të duelojë më 18 maj ndaj Dominic Breazeale, por kjo sfidë ende nuk është zyrtarizuar. Pritet që Wilder të kalojë në platformën televizive DAZN, ku ndodhet edhe Joshua, çka do ta lehtësonte një marrëveshje për duelin mes tyre në fund të 2019-ës. Për "Sky Sports", Eddie Hearn tha: "Situata është shumë inkurajuese. Nuk dua të kaloj në eufori, por si ndërmjetës për të realizuar këtë duel mendoj se këtë herë gjërat janë drejt finalizimit. Nuk e mohoj që marrëdhëniet mes dy stafeve nuk janë të mira, pasi secila anë synon të përfitojë sa më shumë ekonomikisht nga kjo sfidë. Por të dyja palët e duan këtë përballje të madhe dhe unifikimin e titujve kampionë". "Kjo do të jetë sfida më e madhe e boksit e sidomos e peshës së rëndë në dekadën e fundit. kemi dy boksierë të pamposhtur që mund të dhurojnë një duel të madh dhe arkëtojnë shumë. Gjasat janë që kjo përballje të zhvillohet në nëntor ose dhjetor. Nëse dy boksierët humbasin në duelet e radhës dhe humbasin titujt, atëherë situata nuk do të jetë më e njëjtë. Gjithsesi, mendoj se në nëntor të dy boksierët do të jenë kampionë", tha Hearn.

ATLETICO "DENONCON" RONALDON ME PRECEDENTIN PËR PEZULLIM

Sipas "Tuttosport", "Rojiblancos" kanë kërkuar nga UEFA të mbajë qëndrim mbi sjelljen e Ronaldos. Sipas këndvështrimit të tyre, gjesti i portugezit ndryshon nga ai i Simeone për një arsye të thjeshtë: "Cholo" është kthyer nga tifozët e vet, kur bëri atë veprim me duar, ndërsa CR7 iu drejtohej tifozëve kundërshtarë. Për këtë arsye, ato thonë se ishte gjest provokues

Juventusi, pas gëzimit të kualifikimit në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, mbetet i shqetësuar për skualifikimin e mundshëm të Cristiano Ronaldos. Festimi i tij provokues, në përgjigje të gjestit të Simeone, ka hapur shumë diskutime në Spanjë. Atletico Madrid, klub që nuk ka marrëdhënie të mirë me portugezin, dëshiron t'i shkojë deri në fund përplasjes. Sipas "Tuttosport", "Rojiblancos" kanë kërkuar nga UEFA të mbajë qëndrim mbi sjelljen e Ronaldos. Sipas këndvështrimit të tyre, gjesti i portugezit ndryshon nga ai i Simeone për një arsye të thjeshtë: "Cholo" është kthyer nga tifozët e vet, kur bëri atë veprim me duar, ndërsa CR7 iu drejtohej tifozëve kundërshtarë. Për këtë arsye, ato thonë se ishte gjest provokues. Kjo është situata, që e frikëson Juventusin më shumë se çdo tjetër. Në Rregulloret e Disiplinës, në fakt, në nenin 15, sqarohet se provokimi i publikut çon në skualifikimin me një ndeshje, ose për një periudhë të caktuar më tepër se kaq, referuar shkeljes përkatëse. Për momentin, UEFA nuk ka hapur ende ndonjë procedurë disiplinore, por kjo nuk i lë të qetë tifozët bardhezinj. Edhe në rastin e Simeone (më vonë u gjobit me 20 mijë euro), njoftimi i nisjes së procedurës mbërriti disa ditë pas gjestit. Atletico Madrid i referohet edhe një precedenti, që duhet përdorur për të skualifikuar Ronaldon. Dhe nuk flitet për shumë kohë më parë. Dy vite më parë, në ndeshjen e Ligës së Kampionëve mes Celtic dhe Linfield, lojtari i bardhëjeshilëve, Leigh Griffiths, pati disa probleme me tifozët kundërshtarë. Nga këto të fundit u hodhën sende të forta dhe u provokua lojtari. Pastaj, në fund të lojës, vetë Griffiths mori një shall të Celtic dhe e lidhi atë në hyrje të "Windsor Park", stadiumi ku Linfield luan ndeshjet në shtëpi. Gjesti u konsiderua provokues nga UEFA dhe skualifikimi me një ndeshje mbërriti. Me pak fjalë, Juventusi mbetet i alarmuar dhe shpreson që UEFA të kufizohet veten në një gjobë të tipit ekonomik, duke u mbështetur në precedentin më të freskët, që është pikërisht gjesti i Simeone në ndeshjen e parë.

Inter, një dështim i paralajmëruar dhe një revolucion i ri në horizont

Interi e nisi sezonin aktual me shpresa të mëdha, pas përforcimeve serioze në merkato, duke shpresuar te një ecuri sa më e mirë në Champions League dhe të paktën vendi i dytë në kampionat, aty ku të gjithë e dinë që Juventusi është tepër superior. Megjithatë, eliminimi nga Champions League duke mos mundur dot PSV-në dhe eliminimi nga Kupa e Italisë dhanë sinjalin e parë se gjithçka ka qenë një dështim, që është vulosur nga eliminimi i hidhur nga Europa League, ku Eintracht Frankfurt u duk si Barcelona. Nga PSV tek Eintracht, në mes disfata të rënda, parakalim nga Milani dhe sherr me kapitenin Icardi, të cilit iu hoq shiriti dhe tashmë nuk është fare pjesë e ekipit, zyrtarisht për dëmtim. Luciano Spalletti ka justifikime, por deri në një farë pike, sepse dështimi në radhë të parë është i tij, përtej faktit që kundër Frankfurtit nuk kishte në dispozicion as Icardi e as Lautaro. Tashmë trajneri zikaltër ka vetëm një detyrë, të çojë Interin në Champions League dhe të hapë rrugë, sepse duket e sigurt që nuk ka të ardhme tek Interi. As Icardi nuk ka të ardhme zikaltër, shitja e tij është e sigurt tashmë dhe Interi i ardhshëm do të rithemelohet, duke u bazuar te pak emra nga sezoni aktual dhe duke besuar te aftësitë e drejtorit Marotta dhe dëshira për të investuar e presidentit Zhang, gjithnjë me Fair-Play financiar që kërcënon.

Gaitan lë Kinën për Amerikën

Aventurë e re për Nicolas Gaitan. Fantazisti argjentinas i cili ka patur eksperienca të suksesshme te Benfica e më pas te Atletico Madrid mbylli aventurën në Kinë me Dalian Yifang dhe tashmë do luajë përtej oqanit në Major League Soccer me Chicago Fire. Për këta të fundit është goditja e madhe që mbyll merkaton e klubit dhe rrit ambiciet për tu rikthyer te titulli i madh që mungon që prej vitit 1998. 31-vjeçari Gaitan ka firmosur për një sezon por në bazë të performances së tij klubi ka të drejtën për ta zgjatur kontratën edhe me një tjetër sezon.

Monaco kërkon blerjen përfundimtare të Martins

Gelson Martins në vetëm pak javë ka patur një impakt të jashtëzakonshëm te Monaco me 3 gola dhe 1 asist. 23-vjeçari është huazuar deri në verë nga Atletico Madrid dhe drejtuesit e klubit të Principatës dëshirojnë ta blejnë përfundimisht sulmuesin portugez por sipas akordit nuk është parashikuar e drejta e blerjes pas huazimit. Për të bindur "Los Colchoneros" për ta lënë të lirë Martins janë gati të ofrojnë 40 milionë euro plus bonuset në varësi të performancës, shifër kjo që po tundon drejtuesit spanjoll duke parë se me Simeonen portugezi nuk ka hapësira në fushë.

Bale drejt largimit

Zinedine Zidane u rikthye në stolin e Real Madridit, një yll i fushës së blertë mund të largohet që aty. Mediat spanjolle e shohin të paevitueshëm këtë "reaksion" shkak-pasojë, ku Gareth Bale është protagonist. Uellsiani konsiderohet si një nga shkaqet e largimit të francezit verën e vitit të kaluar, ndërkohë që tani i duhet të dalë "para gjyqit". Situatat kanë ndryshuar, me Zidane që tashmë ka dorë të lirë për të afruar e larguar kë të dojë. Në fakt, Bale ka kaluar disa muaj të vështirë në kryeqytetin spanjoll dhe shpesh është vërshëllyer nga tifozët e bardhë. 29-vjeçari nuk duket të jetë shumë i afërt me shokët e ekipit dhe portieri Thibaut Courtois e ka kritikuar publikisht kohët e fundit. Si rezultat i të gjitha këtyre, ish-ylli i Tottenham është lidhur me një lëvizje larg "Bernabeut". Sidoqoftë, agjenti i tij, Jonathan Barnett, ka mohuar se ka ndonjë të vërtetë në raporte të tilla. Madje, thotë se klienti i tij do të donte ta vijonte pjesën e mbetur të karrierës në këtë klub: "Ai dëshiron ta mbyllë karrierën te Real Madridi. Gareth do të flasë me Zidane, do të marrë mendimin e trajnerit për të dhe pastaj do të shohim çdo të ndodhë në fund të sezonit". Mediat spanjolle shkruajnë se uellsiani nuk pati marrëdhënie të mira me Zidane, gjatë qëndrimit të tij të parë si trajner, diçkaje që Bennet nuk i fshihet: "Gareth donte të luante në një mënyrë dhe Zidane në një tjetër. Ky ishte shkaku i raportit mes tyre, që gjatë një periudhe kohore u përkeqësua. Nëse trajneri e lejon Bale të luajë në mënyrën e duhur, ai mund të jetë i barabartë me Cristiano Ronaldon. Ka ende një potencial të madh, është shumë i fortë, me vullnet të madh dhe nuk kujdeset për ato që thonë mediat".

HIDHET SHORTI I LIGËS SË KAMPIONËVE

KATËR SUPERSFIDA NË ÇEREKFINALE

Në Nyon të Zvicrës u hodh shorti për fazën çerekfinale të Champions League, aty ku 8 skuadra kanë mësuar përballjet e tyre. Në këtë short janë përcaktuar edhe datat e ndeshjeve dhe ekipet pritëse

Short pozitiv për Juventusin dhe Liverpulin, dy ndër favoritët kryesorë për fitmin e trofeut. Bardhezinjtë e Alegrit do të përballen me Ajaksin. Ndeshja e parë do të zhvillohet në Holandë. Nëse kualifikohet, Juventusi do të ndeshjet në gjysmëfinale me Totenhemin ose Sitin. Short shumë i mirë edhe për Liverpulin e Klopit. Finalistët e vjetshëm do të luftojnë kundër Portos për një vend në gjysmëfinale. Ndeshja e parë do të zhvillohet në "Anfield", ndërsa ajo e kthimit në Portugali. Kush kualifikohet më tej do të luajë kundër fituesit të çiftit Barcelona-Mançester Junajtid. Përballje e fortë angleze midis Totenhemit dhe Mançester Sitit. "Qytetarët" janë të lumtur që do të luajnë ndeshjen e kthimit në stadiumin e tyre, ndërsa djemtë e Poçetinos ëndërrojnë finalen e madhe. Duel i bukur dhe ai midis Barcelonës dhe Mançester Junajtid. Ekipi i Leo Mesit mbetet favorit për të kaluar, por "Djajtë e Kuq" kanë treguar se me Solskjaer në stol mund të dhurojnë surpriza pafund. Ndeshjet e para do të zhvillohen me datë 9 dhe 10 mars, ndërsa ato të kthimeve do të luhen pas 1 jave, konkretisht me 16 dhe 17 prill. Në fazën gjysmë finale do të përballet fituesi mes Totenhemit-Mançester Siti me skuadrën fituese mes çiftit Ajaks-Juventus. Fituesi i Barcelona-Mançester do jetë ekipi pritës mes fituesit të sfidës Liverpul-Porto. Ekipi pritës në finalen e madhe të "Wanda Metropolitano" do jetë skuadra që do fitojë mes sfidave: Totenham-Mançester Siti dhe Ajaks-Juventus. Zv. Presidenti Pavel Nedved i Juventusit ka folur për takimin me Ajaxin. Ky i fundit ka vlerësuar lartë ekipin holandez, duke kujtuar se ata eliminuan kampionin e garës më prestigjioze evropiane për klube. "Unë nuk jam as i lumtur, as i pakënaqur. Ajaksi e ka eliminuar Madridin, kështu që ata nuk janë për t'u nënvlerësuar. Mua më kanë pëlqyer shumë kundër Madridit, kështu që duhet të jemi shumë të kujdesshëm pasi që do të përballemi me Ajaksin që ka entuziazëm të madh", pohoi ish-reprezentuesi çek. Kujtojmë se Ajaksi fitoi dy ndeshjet e para kundër Juves – përfshirë të parën, në finalen e Kupës Evropiane të vitit 1973 në Beograd (1-0). Holandezët nuk kanë triumfuar kundër Bianconerëve që nga ajo kohë. Ndërkohë, Juventusi është i pamposhtur në dhjetë takimet e fundit me Ajaksin (F6, B4), duke fituar pesë nga gjashtë të fundit. Ndryshe, Juventusi në rast të mposhtjes së Ajaksit, ka mundësi që të takohet me fituesin e çiftit, Totenham Hotspurs-Mançester Siti. Allegri? "Ne kemi ndërmarrë hapa që i kemi marrë çdo vit. Presidenti u takua me trajnerin dhe e solli vendimin në qershor, duhet të jemi të lumtur me Allegrin, atë që ai po bën në kampionat është e jashtëzakonshme. Jemi 18 pikë përpara në kampionat, Shampions League ... jemi aty ku duam të jemi". Skualifikimi i Ronaldo-s për gjestin ndaj Ateltiko Madrid? "Nuk kam frikë, është një gjest që ka mbetur në fushë. Ai reagoi pasi u fye kaq shumë në Madrid dhe nga tifozët e tyre në shtëpinë tonë, unë nuk mendoj se do të ketë përjashtime", ka theksuar Nedved. Guillermo Amor, Drejtor i Marrëdhënieve Institucionale të Barcelonës, foli për "Movistar", menjëherë pas shortit të sotëm, që i përballi katalanasit me Manchester United në çerekfinale të Champions-it: "Duhet të jesh i lumtur me shortin në këtë fazë. Me cilindo që do të na binte, vështirësia do të ishte e madhe. Manchester United është një nga skuadrat e mëdha, do të luajmë dy finale kundër tij. Secila sfidë çerekfinale do të jetë shumë e rëndësishme. Luajtja në shtëpi, ose larg në ndeshjen e parë apo të dytë nuk të garanton suksesin. Eshtë e vërtetë që, nëse udhëtoni në ndeshjen e parë, në shtëpi mund ta "gjurmosh" rezultatin, e di se çfarë të duhet, por është e vështirë të flitet për favor. Le të shkojmë në Manchester për të marrë një rezultat të mirë për kthimin në shtëpi. Nëse dëshiron të jesh kampion, duhet të fitosh ndaj kujtdo dhe kudo, të japësh gjithçka. Ne duhet të përqendrohemi te çerekfinalet dhe të mos mendojmë për më tej, gjysmëfinalet".

Hidhet shorti për çerekfinalen e Ligës së Evropës

Është hedhur shorti nga UEFA edhe për ndeshjet çerekfinalet në Ligën e Evropës. Tetë skuadrat që kanë siguruar çerekfinalen do të synojnë të shkojnë tutje. Chelsea, Napoli, Valencia, Villareal, Benfica, Arsenal, Eintracht Frankfurt dhe Slavia e Pragës janë ekipet çerekfinaliste. Ndeshja kryesore në këtë raund do të jetë mes dy favoritëve për ta fituar trofeun, mes Napolit dhe Arsenalit. Shorti deshi që në çerekfinale të ketë një përballje spanjolle mes Villarealit dhe Valencias. Benfica do të jetë nikoqire në ndeshjen e parë përballë befasisë së Eintracht Frankfurtit. Ndërkohë Chelseat i ka buzëqeshur fati pasi do të përballet me Slavian e Pragës.

ÇIFTET:

Napoli – Arsenal
Villareal – Valencia
Benfica – Eintracht Frankfurt
Chelsea – Slavia Praga

Suarez: Gerrard s'më lejoi të shkoj në Arsenal

Luis Suarez ka zbuluar se Steven Gerrard kishte ndërhyrë për ta ndaluar atë të mos largohej nga Arsenali verën e vitit 2013. Vetëm 18 muaj pasi kishte kaluar në Liverpool nga Ajaxi, Suarezi kishte tentuar ta detyronte ekipin ta shiste në Arsenal, për shkak se të kuqtë kishin dështuar të kualifikoheshin në Ligën e Kampionëve. Liverpooli kishte këmbëngulur në vendimin e tij për të mos e shitur uruguaianin te rivali i Premierligës dhe Suarez – i cili përfundimisht iu bashkua Barcelonës vetëm një vit më vonë, 2014, për një shumë të majme parash – zbulon se Gerrardi e kishte bindur të mos i bashkohej Arsenalit. "Ne u kualifikuam në Europa League por sezoni mbaroi keq për ne", tha Suarez për Otro. "Isha gati t'i bashkohesha Arsenalit, e detyroja veten të shkoja, por Steven erdhi dhe më tha: 'Të premtoj se nëse qëndron këtë vit, atëherë vitin tjetër do të shkosh në Bayern, Barcelona, Real Madrid apo në cilindo ekip që dëshiron, por qëndro këtë vit sepse në Arsenal nuk do të gjesh më mirë'", zbuloi Suarez. "Kjo ishte biseda ime e fundit me Gerrardin në atë moment dhe i thashë menaxherit tim se vendosa të qëndroj", shtoi ai.

Bryant: Barcelona dhe Messi fitojnë "tripletën"

Kobe Bryant ka një marrëdhënie të mirë me disa nga yjet e Barcelonës. Megjithëse ekipi i tij i fëmijërisë, për të cilin ka bërë tifo, është Milani, ai ka treguar simpati për klubin katalanas. Ylli i mëparshëm i Lakers-it e ndjek situatën aktuale të Barcelonës dhe, pasi u kualifikua në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, sheh Messin dhe të tijtë si favoritë për të fituar "tripletën" sezonale. Ai do të nënvizonte: "Do të jetë shumë e vështirë, por e mundur. Verën e kaluar fola me Pique dhe kemi debatuar pak për kohën e pushimit, që kanë futbollistët. Basketbollistët kanë më shumë kohë për të pushuar në verë, ndërsa në futboll ke një javë, ose dy. Për të mbajtur këtë nivel çdo vit është shumë e vështirë, por nga mënyra se si luan Barça, mendoj se "tripleta" është një mundësi reale këtë sezon". Ndërsa po fliste, ish-basketbollisti i madh "kryqëzoi gishtat", duke i dërguar një mesazh në italisht Leo Messit: "Paç fat argjentinos"! Më herët, Kobe Bryant ka treguar se si mësoi për ekzistencën e Messit. Në një takim me Ronaldinhon, braziliani ia paraqiti argjentinasin si "lojtarin më të mirë në botë". Prej asaj kohe, Kobe thotë se e ka ndjekur rregullisht ecurinë e Messit me Barçën.

DASHI — **21. mars - 20. prill**

Mbrojeni nga te gjithë jetën tuaj ne çift sot dhe mundohuni te kaloni me tepër kohe me partnerin. Po e late shume pas dore ai mund te shohë dike tjetër. Beqaret nuk do hakojnë një dite te bukur dhe do mungojnë njohjet e reja. Kjo nuk është dita juaj me fat. Financat do i riorganizoni dhe gjendja do filloje te përmirësohet tej mase.

DEMI — **21. prill - 21. maj**

Do jeni shume te sjellshëm sot ju te dashuruarit dhe do bëni te pamundurën qe personi qe keni ne krah te ndihet sa me mire. Beqaret kot sa te mundohen ta kërkojnë dashurinë sepse sipas planetëve, kjo nuk është dita me e mire për ta. Te ardhurat do përmirësohen dalëngadalë. Gjithsesi kjo nuk do te thotë qe ju menjëherë te filloni shpenzimet sepse do ishte nja gabim i rende.

BINJAKET — **22. maj - 21. qershor**

Qetësia do mbizotërojë gjithë kohës sot ne jetën tuaj ne çift. Nuk do keni për çfarë te qaheni për asgjë. Beqaret do kenë një dite te mbushur me te reja. Ata do takohen ne mëngjes me disa persona dhe do shoqërohen gjithë ditën me ta për t'i njohur me mire. Ka shprese qe te fillojnë shpejt një lidhje afatgjate. Ne planin financiar duhet te reflektoni gjere e gjate.

GAFORRJA — **22. qershor - 22. korrik**

Sipas parashikimeve, jeta juaj ne çift ka për te qene shume me e veçante sot. Do keni ide interesante si ta bëni partnerin t'iu dashuroje edhe me tepër. Beqaret do kenë dashuri me shikim te pare atëherë kur nuk do e presin. E rëndësishme është qe jeta e tyre do ece ne drejtimin e duhur. Buxheti do jete goxha i mire, megjithatë nuk duhen kryer shume shpenzime.

LUANI — **23. korrik - 22. gusht**

Do jeni shume te sinqerte me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe marrëdhënia me te sa do vije e do përmirësohet akoma me shume. Beqaret do jene inteligjente dhe do bëjnë zgjedhjen e duhur. Jeta do ju ndryshoje brenda pak orësh. Financat do mbeten te mira. Duhet ta shfrytëzoni këtë mundësi për te bere investimet qe keni menduar prej kohesh pasi me vone nuk i dihet çfarë ndodh.

VIRGJERESHA — **23. gusht - 23. shtator**

Fale ndikimit pozitiv te yjeve, sot do i zgjidhni edhe disa mosmarrëveshje te vogla qe keni pasur me partnerin dhe do i shihni gjerat me optimizëm. Beqaret do realizojnë një takim ekzaltues dhe vendimtar, i cili do ua ndryshoje përgjithmonë te ardhmen. Ne planin financiar perspektivat janë goxha te mira. Mundohuni te përfitoni nga kjo situate për te hequr para mënjanë dhe për te shlyer borxhet.

PESHORJA — **24. shtator - 23. tetor**

Jeta juaj ne çift do ketë përmirësime te mëdha gjate gjithë kësaj dite. Do arrini te flisni për çdo gjë me partnerin dhe do bini dakord me te. Beqaret nuk duhet te ëndërrojnë me shume sesa duhet pasi do zhgënjehen tej mase. Me mire le te qëndrojnë me këmbë ne toke. Ne planin financiar mundohuni te tregoheni te matur me shpenzimet qe te siguroni edhe te ardhmen.

AKREPI — **24. tetor - 22. nëntor**

Mundohuni te mos provokoni xhelozinë e partnerit tuaj gjate kësaj dite sepse atëherë kur te mos e prisni situata mund t'iu dale jashtë kontrollit. Beqaret do kenë një dite shume te trazuar. Ata do realizojnë disa takime dhe nuk do dini çfarë zgjedhje te bëjnë. Ne planin financiar fati do jete gjithë kohës ne anën tuaj. Nuk do e keni aspak te vështirë te kryeni shpenzimet e nevojshme.

SHIGJETARI — **23. nëntor - 21. dhjetor**

Venusi do e mbroje gjate gjithë kohës jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Çdo gjë do ece mire mes jush dhe atij qe keni nr krah, madje do i shprehni akoma me tepër ndjenjat. Beqaret do kenë disa takime serioze dhe me shume gjase mund te ndryshojnë edhe statusin. Buxheti nuk do ketë probleme nëse i menaxhoni me maturi paratë qe do keni neper duar.

BRICJAPI — **22. dhjetor - 20. janar**

Do bashkëpunoni pafund me partnerin tuaj sot dhe se bashku do përbëni një ekip te forte. Askush nuk do ua prishe dot harmoninë. Beqaret do jene te lire te bëjnë atë qe do mendojnë te arsyeshme. Parashikohet qe jeta shume shpejt t'ju ndryshoje për mire. Ne planin financiar nuk duhet te ndërmerrni shume rreziqe. Paratë qe keni shfrytëzojini për te bere investime te domosdoshme.

UJORI — **21. janar - 19. shkurt**

Ka rrezik qe jeta juaj ne çift te mos ece ashtu si duhet sot. Here pas here keni për te pasur edhe debate te forta me partnerin dhe për fat te keq asnjeri nuk do hape rruge. Beqaret ka rrezik te fillojnë një lidhje qe do ju sjelle me shume mërzitje sesa kënaqësi. Financat do jene te mira kështu qe mund te kryeni pa frike investimet qe keni menduar. Po mundet, ndihmojini edhe pak te afërmit.

PESHQIT — **20. shkurt - 20. mars**

Dite sensuale dhe e mbushur me pozitivizëm do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Do përjetoni vetëm emocione pozitive pranë atij qe dashuroni dhe nuk do keni për çfarë te qaheni. Beqaret duhet te joshin pa dorashka sepse sot do ju ofrohen mundësi te mira. Ne planin financiar do mbizotërojë qëndrueshmëria. Nuk duhet ta teproni me shpenzimet, por as ta kufizoni shume veten.



FJALËKRYQ KLASIK



HORIZONTALISHT:

1. Shenjë ndalimi; **5.** I trashë nga mendja, torollak; **10.** Këngëtarja jonë, Baraku; **11.** Shenj në trupnjollë, balë (shq.); **12.** Mbyll diçka me bravë; **14.** Lloj ocjeje kali; **15.** Element kimik (Te); **17.** Kevin Kostner; **18.** Tori Speling; **20.** E ndot me lerë; **22.** Aktorja, Rina; **24.** Ardhja e sërishme e krishtit (fet.); **26.** Mbulesë tryeze, dysheku etj. (shum.); **28.** Princ trojan; **29.** Jetë e qetë dhe e lumtur (sh.poshq.); **30.** Sergjen, dollap.

VERTIKALISHT:

1. Ish tenistja argjentinase, Gabriela; **2.** Transporte ndërkombëtare mugore; **3.** Dhomat; **4.** Futbollisti çek, Medved; **5.** Që është pa kuptim, jashtë mendjes; **6.** Shkruaj: Ll. L.; **7.** Aktori amerikan, Noris; **8.** Qytet në Koreinë Veriore; **9.** Kapelë burrash me streh (shum.); **13.** Kripa me thartirë të oleinës; **16.** Markë automobili anglez; **19.** Fazë, etapë; **21.** Ish automobilisti brazilian në F1, Ajrton; **23.** Agjensi gazetareske hinduse; **25.** Anijatë (arkit.); **27.** Simboli kimik i aluminit.

ZGJIDHJET: BOLSHOVONTI, EMTEL, RAJA, TM, KIS, TRA, IR, VARANAK, SOA, L, Q, UTU, IAU, P, T, TRA, KO, BRIN, KOM, TOT, CO, BA, MAZ, A, N, IM, TEMA, NOM, F, RUM, OS, MALBORO, BRGAN, ROS, EMRAQI, NOMA, TMU, TREIN, FJALËKRYQ KLASIK: STOP, ALUQIM, ADA, BLAMA, BRAVOS, KAS, A, TELLIM, KK, TI, LEMOS, E, ITALIANT, NMM, ENEA, IDLE, MVT.

16 VJEÇARJA NOMINOHET PËR ÇMIMIN NOBEL PËR PAQE

Greta Thunberg, themeluese e lëvizjes "Youth Strike for Climate", është nominuar për çmimin Nobel për Paqe, vetëm një ditë para aksionit më të madh global për ndryshimet klimatike. Thunberg, 16 vjeçare, e nisi e vetme një protestë në muajin gusht në Suedi, por që prej atëherë ajo ka inspiruar nxënës e studentë në të gjithë botën. Greva e të Rinjve për Klimën fton nxënësit që çdo të premte të bojkotojnë mësimin dhe të protestojnë për ndryshimet klimatike. Deputeti socialist norvegjez, Freddy Andre Ovstegard, deklaroi se veprimi i Thunberg është një kontribut i madh për paqen. "Ne e kemi nominuar Greta Thunbergun sepse nëse ne nuk bëjmë asgjë për ndryshimet klimatike, kjo do të bëhet shkaktare për luftë, konflikte dhe refugjatë", tha ai. Përmes Twitterit, Greta u shpreh falënderuese për nominimin e saj. "Jam shumë e nderuar dhe mirënjohëse për këtë nominim. Nesër ne do të bojkotojmë mësimin për të ardhmen tonë. Dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë derisa të jetë nevoja", shkroi ajo. Bojkotimi i mësimit, ndryshe si greva apo protesta për ndryshimet klimatike, pritet të ndodhë në 1,659 qytete në 105 vende të ndryshme të botës, duke përfshirë qindra mijë nxënës e studentë.

Ballina e gazetës KOHA në tortë festive

Aktorja Drita Kaba Karaga në një postim të saj në Fejsbuk ka uruar ditëlindjen e babait të saj, Selajdin Kaba. Pjesë dekorative e tortës për ditëlindje ishte edhe ballina e gazetës KOHA, pasi z.Kaba është lexues i rregullt i gazetës sonë. Selajdin Kaba është arsimtar i Fizkulturës, ndërsa më 1981 ishte larguar nga puna pasi u burgosë si shumë arsimtarë tjerë shqiptarë. Redaksia e gazetës KOHA z.Kaba i dëshiron shëndet, jetë të gjatë dhe të lumtur.

"Robin Hood" shpërndan zarfe me para banorëve

Një zarf plot me para në kutinë postare ose poshtë derës. Kjo është surpriza e bukur që janë përballur disa banorë të Villarramiel, një fshat me 1 mijë banor në veri të Spanjës. Prej një javë një person i paidentifikuar dhe që quhet nga banorët, 'Robin Hood i shekullit 21' po shpërndan para për disa prej familjeve të fshatit. Në zarf ka kartëmonedha 50 dhe 100 euro. Po kush i shpërndan këto para? Për momentin nuk dihet personi që bën një bën një bamirësi të tillë. "Nuk e dimë se kush fshihet pas këtyre dhuratave për banorët dhe se çfarë kuptimi ka kjo bujari e çuditshme", ka thënë kryetarja e bashkisë, Nuria Simon. Disa prej personave që morën zarfe me para shkuan në polici për t'i dorëzuar ose në bankë për të kontrolluar a ishin të vërteta ose false. Por paratë e shpërndara pas verifikimeve ishin të vërteta.

Kur celulari të shpëton jetën

Ndodh që celulari t'iu shpëtojë jetën në situata të caktuara. Kjo i ka ndodhur një burri në Australi, i cili u godit me një shigjetë, por për fat të mirë preku telefonin. Sipas policisë, 43-vjeçari u sulmua nga një person tjetër 39-vjeçar. Incidenti ndodhi jashtë shtëpisë së tij, kur banori nxori celularin për të filmuar konfliktin me të. Por, në këtë moment autori e qëlloi me shigjetë. Kjo e fundit goditi celularin dhe për fat të mirë 43-vjeçari pësoi vetëm një gërvishtje të vogël në fytyrë pa pasoja serioze. Autori 39-vjeçar u arrestua më pas nga policia. Ngjarja ka ndodhur në qytetin New South Wales rreth 180 km në jug të Brisbanes. Të dy personat kanë njohje me njëri-tjetrin, por autoritetet nuk dhanë informacione të tjera më të hollësishme. 39-vjeçari akuzohet për sulm fizik dhe dëmtim të pronës.

U braktis në pyll, gjendet vogëlushja e pickuar nga insektet

Një foshnje e vogël është gjetur nga kalimtarët e zonën në Filipine. Vajza është braktisur nga prindërit dhe është lënë në një zonë të pabanuar në ishullin Olango, Filipine mëngjesin e së martës. Ajo ishte pickuar nga insektet dhe është gjetur në një gjendje të rëndë. Ka qenë një banor i zonën ai që e ka gjetur të voglën pa rroba dhe pa asnjë mbulesë, pranë një shkurreje teksa termometri shënonte 35 gradë celsius. Eliezer Rosalejos ishte një nga njerëzit që ndihmoi në shpëtimin e foshnjës. Ai tha: "Falënderoj Zotin që foshnja ishte ende gjallë dhe e kemi gjetur atë në kohë. Kushdo që janë prindërit e saj, unë shpresoj se ata ndjehen fajtorë. Fëmijët janë aq të çmuar, nuk do ta kuptoj kurrë se si dikush mund ta linte fëmijën e vet në mëshirën e fatit. Ajo është aktualisht në spital dhe është në kujdesin e mjekëve. Zyrtarët e Policisë së ishullit Olango po kontrollojnë të dhënat mjekësore për të gjetur nënën. Një zëdhënës tha: "Është e rëndësishme që ne të gjejmë nënën në mënyrë që ajo të marrë ndihmën e nevojshme dhe të mbajë përgjegjësinë për veprimet e saja.

KALENDARI HISTORIK 16 MARS

597 BC - Babilonasit pushtojnë Jerusalemin.

1521 - Lundruesi portugez Ferdinand Magellan arrin në Filipine.

1690 - Mbreti francez Luigji XIV dërgon trupa në Irlandë.

1815 - Willem I shpallet mbreti i Holandës dhe i Belgjikës.

1922 - Sulltan Fuadi I emërohet Mbret i Egjiptit. Anglia njeh Egjiptin.

1939 - Gjermania okupon Çekosllovakinë.

1955 - Josephine Kroesen emërohet Gjykatësja e parë femër në Holandë.

1959 - Iraku dhe BRSS nënshkruajë traktat ekonomik.

1968 - Masakra e My Lai gjatë Luftës së Vietnamit (vriten 450 persona).

1978 - SHBA pranon Traktatin e Kanalit të Panamasë.

1985 - Korrespondenti i Associated Press, Terry Anderson zihet peng në Bejrut.

2005 - Izraeli zyrtarisht dorëzon Xherikon nën kontrollin palestinez.

2006 - Asambleja e Përgjithshme e OKB voton në mënyrë të jashtëzakonshme themelimin e Këshillit të KB për të Drejtat e Njeriut.

A E DINI SE...

Në trupin e një njeriu mesatar gjenden mbi 97.000 km të enëve të gjakut.

Një astronaut mund të zgjatet për 5 centimetra pasi të kthehet nga gjithësia pasi që disqet e kërceve të shpinës zgjerohen në mungesë të gravitetit



Çita është gjitari më i shpejtë në tokë. Ajo mund të rritë shpejtësinë prej 0 deri në 70 km/h brenda 3 sekondave.

BARSOLETA

MAGJISTAR NË SHKOLLË

Beni kthehet nga shkolla me hundë të gjakosur, E ëma fillon të bërtasë: Bobo, ç'të ndodhi, ndonjë aksident?
- Jo...e ka fajin magjistari.
- Cili magjistar?
- Erdhi ne shkollë për shfaqja. Më mori në skenë dhe me nxori 10 euro nga hundët.
- A maskarai...!
- Jo jo, në fakt ai nuk bëri gjë, fajin e kanë shokët e klasës. Pasi iku magjistari filluan të kërkojnë a ka para të tjera në hundë...

THËNIA E DITËS

Mund t'i rezistosh një pushtimi të ushtrisë, por nuk mund t'i rezistosh një pushtimi të ideve.
(Viktor Hygo)